

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7472 E diel 18 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga SPARTAK NGJELA

Shqipja, gjuhë e dytë
edhe në Malin e Zi



Opinion

Ditës

Nga DRITAN HILA

Histori e shkurtër
e Rusisë dhe Putin

Epate banditin Gruevski si i kërcënues gjeneralit shqiptar? Po gjeneralin shqiptar, Talat Xhaferi, a e patë sesi nuk e përfilli fare, por vijoi punën në emër ...
Vijon në faqen 21

Nëse do të gjendej një përkufizim dashamirës që shqiptarët mund t'i gjenin Rusisë, do të ishte "mike e sllavëve të jugut". Një cilësim realist është "copëtuese ...
Vijon në faqen 22



ALUIZNI: Emrat në çdo njësi të Tiranës

320 pronarët që marrin lejen e legalizimit për shtesat e shtëpive

Ndërtuan pa leje, lista me 43 familjet që duhet të plotësojnë dokumentacionin për të marrë tapinë

Nga ORNELA MANJANI

ALUIZNI publikon listën me 321 personat që kanë ndërtuar shtesa pa leje dhe kanë gati lejen e legalizimit. Përfutuesit duhet të paraqiten pranë drejtorisë së ALUIZNI-t "Tirana 2". Gjithashtu, pranë kësaj drejtorie duhet ...

Në faqen 10-11

OPERACIONI/ GODITEN 7 GRUPE, DERGONIN SHQIPTARE ME DOKUMENTE FALSE

SKEME TRAFIKIMI NE SHBA E ANGLI, 39 TE ARRESTUAR

Shqiptarët paguanin nga 7 mijë paund deri në 25 mijë dollarë për t'u larguar nga vendi. 4 policë në pranga, rrjeti përcollti 1 mijë emigrantë të paligjshëm



(Në foto) Momenti i arrestimit të trafikantëve. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Ardi Veliu. Materialet e sekuestruara

Në faqen 2-3

FJALIMI I PRESIDENTIT

Meta në Azerbajxhan: BE-ja pa Ballkanin është një projekt i papërfunduar

Në faqen 6

ARRESTIMI NE LEZHE

Lulzim Basha: Hetim jopolitik dhe transparent për Fran Frrokajn

Në faqen 4

KRIMI NE VLORE

Sherri për pronat, vret kushëririn me sëpatë në kokë në sy të djalit

Në faqen 9

"NUSJA VRASESE"

Helmoi vjehrrën, 21-vjeçarja takon në burg vajzën 6 muajshe

Në faqen 9

FORMULARET E RINJ



Kërkesat dhe ankesat në ATP, procedura e re për ish-pronarët

Në faqen 7

INTERVISTA me nobelistin francez të 2008-s për mistikën dhe romancën

Le Clezio: Letërsia, t'i bëjë jehonë kaosit

Në brendësi: Analizë nga Albert Doja, poezi nga Demir Gjergji

Nga FRANCE DIPLOMATIE

Në panoramën letrare franceze Jean Marie Gustav Le Clezio zë një vend të veçantë për sa i përket të grupeve, shkollave, modeve. Francez dhe maurician njëherësh, i mësuar, i rritur me kulturën frënge



dhe njohës i hollë i letërsisë anglo-saksone, ky romancier i jashtëzakonshëm mburret me Lotremoinin, Zolain, por gjithashtu me Stivensonin dhe Xhojsin. Kritika gjithnjë ka hequr keq ta ngacmojë, ta kufizojë në ndonjë ...

Suplement

TRAFIKU I KLANDESTINEVE ARRESTIMET

Ja itineraret që përdornin grupet kriminale për trafikimin e emigrantëve të paligjshëm

Klandestinë me pasaporta false, si funksiononte skema e trafikut

Shqiptarët paguanin 7 mijë paund për në Angli dhe 25 deri në 30 mijë dollarë për në SHBA e Kanada

TIRANË

Pas finalizimit të mega operacionit, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me trafikimin e emigrantëve shqiptarë. Mësohet se personat e arrestuar bënë falsifikimin e dokumenteve për emigrantët e paligjshëm që kanë dërguar në Britani, SHBA, Kanada dhe Irlandë, sikur këta të fundit ishin shtetas evropianë, bullgarë apo të tjerë. Mësohet se për trafikimin drejt Britanisë së Madhe, grupet kriminale merrnin nga 7 mijë paund për person. Ndërsa, për në SHBA dhe Kanada, personat e arrestuar merrnin nga 25 mijë deri në 30 mijë dollarë. Gjithashtu, bëhet me dije se 7 grupet kriminale kanë përfutur rreth 25 milionë dollarë nga trafikimi i emigrantëve. Kjo për faktin se rreth 200 shqiptarë janë dërguar në Britani, ndërsa 800 të tjerë në SHBA dhe Kanada. Burime zyrtare nga Policia e Shtetit kanë zbardhur dhe itineraret që përdornin personat e arrestuar për të trafikuar shqiptarët. Po ashtu pohohet se ky rrjet i stërmadh kriminal kishte shtrirje në disa rrethe të Shqipërisë, por me bazë në Lezhë dhe u ofronte personave të interesuar pasaporta të BE-së të falsifikuara.

SKEMA E TRAFIKUT

Sipas burimeve nga policia, personat e përfshirë në trafikun klandestin pasi dublikonin pasaportat, vidhnin identitetet dhe më pas vendosnin fotot e personave që interesoheshin për të ikur në SHBA aponë Kanada. Burime për "GSH" bënë me dije se operacioni ka nisur prej më shumë se një viti më parë, ndërsa përveç policisë shqiptare, ky operacion u asistua edhe nga oficerë të SHBA-së. Të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit, po vijojnë aksionin paralelisht në Tiranë, Lezhë, Kukës, Dibër, Shkodër dhe Korçë, ku janë shoqëruar dhe arrestuar dhjetëra



Drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu gjatë konferencës për shtyp

PAGESAT

Mësohet se për trafikimin drejt Britanisë së Madhe, grupet kriminale merrnin nga 7 mijë paund për person. Ndërsa, për në SHBA dhe Kanada, personat e arrestuar merrnin nga 25 mijë deri në 30 mijë dollarë. Gjithashtu, bëhet me dije se 7 grupet kriminale kanë përfutur rreth 25 milionë dollarë nga trafikimi i emigrantëve.

Roli i 2 agentëve amerikanë të atashuar pranë ambasadës së SHBA-ve

Rrjeti i trafikut të klandestinëve shqiptarë, në pranga 4 policë të Qafë Thanës e 1 i Hanit të Hotit

TIRANË - Mes personave të arrestuar pas mega-aksionit që u finalizua me shkatërrimi 7 grupeve kriminale që merreshin me trafik klandestinesh shqiptarë, janë edhe 4 punonjës të policisë të Hanit dhe Hotit dhe të Qafë-Thanës. Drejtori i Policisë, Ardi Veliu në një deklaratë për media tha se mes personave të arrestuar janë dhe 3 punonjës të pikës kufitare të Qafë-Thanës dhe 1 polic i Hanit



të Hotit. Bëhet fjalë për shtetasit: Çelnic Maksuti, 53 vjeç, lindur e banues në Pogradec me detyrë kontrollor në Pikën e Kalimit Kufitar të


Qafë Thanës; Ilir Ismaili, 32 vjeç, lindur e banues në Pogradec, me detyrë kontrollor në Pikën e Kalimit Kufitar të Qafë Thanës; Erjon Maxhari, 28 vjeç, lindur e banues në Pogradec, me detyrë kontrollor në Pikën e Kalimit Kufitar të Qafë Thanës si dhe Gjokë Ujkaj, 46 vjeç, lindur e banues në Shkodër, me detyrë kontrollor në Pikën e Kalimit Kufitar Hani i Hotit Shkodër.

por edhe shumta të ndryshme monetare. Për operacionin punuan edhe 2 agentë speciale të Shërbimit Diplomatik të Sigurisë së Departamentit Amerikan të Shtetit, të atashuar pranë ambasadës së SHBA-ve në Tiranë.

ITINERARET E TRAFIKUT KLANDESTIN

Sipas burimeve zyrtare

nga Policia e Shtetit, itineraret që përdornin pjesëtarët e 7 grupeve të strukturuar kriminale janë: Shqipëri-Itali- Mbretëri e Bashkuar; Shqipëri-Francë-Mbretëri e Bashkuar; Shqipëri- Bullgari-Belgjikë- Republika Domenikane-SHBA/Kanada dhe Shqipëri- Spanjë-Amerika Latine-SHBA/Kanada.



Materialet e sekuestruara nga policia gjatë megaoperacionit, ku u arrestuan 39 persona

KONTROLLET

Nga kontrollet, personave që u arrestuan u janë sekuestruar shumë dokumente, pajisje që shërbenin për falsifikimet, por edhe shumta të ndryshme monetare. Për operacionin punuan edhe 2 agentë speciale të Shërbimit Diplomatik të Sigurisë së Departamentit Amerikan të Shtetit, të atashuar pranë ambasadës së SHBA-ve në Tiranë.



"Ranishta 4", shoqërohen dhe 3 persona të tjerë për abuzimin me pronat në Shëngjin

LEZHË - Një ditë pas arrestimit të kryebashkiakut të Lezhës, Fran Frrokaj dhe 11 zyrtarëve e personave të tjerë që akuzohen se kanë abuzuar me pronat në bregdetin e Shëngjinit, policia vijon operacionin për të arrestuar personat e shpallur në kërkim gjatë operacionit "Ranishta 4". Kontrollet kanë nisur që prej ditës së premtë. Deri tani mësohet se janë shoqëruar tre persona të tjerë që janë të përfshirë në skemën e tjetërsimit të pronave. Ndërkaq, burime për "Gazeta Shqiptare" pohuan se hetimi për abuzimin me pronat tek zona e "Ranës së hedhun" në Shëngjin nisi pas denoncimit të bërë nga banorët. Pjetër Prela dhe Gjek Celaj, janë dy nga personat që denoncuan abuzimet me tokat në këtë zonë. Dëshmia e tyre shërbeu për nisjen e një hetimi që tashmë pas nëntë muajsh ka çuar në pranga 12 persona mes të cilëve kryebashkiaku e Lezhës, Fran Frrokaj, zëvendësin e tij, Enver Hafizi e kreun e Këshillit të qarkut, Gjon Ndoka. Denoncuesit treguan në korrik dhe shtator të 2017, fakte të pakundërshtueshme, se përmes dokumenteve të falsifikuara, pronarë të tokave në malin e Shëngjinit dhe malin e Rëncit, po bëheshin persona që nuk kishin qenë asnjëherë banorë në këtë zonë. Që asokohe ata hidhnin dyshime, se në skemën e tjetërsimit të pronave, ishin të përfshirë zyrtarë të lartë lokalë.

Policia: Aktiviteti kriminal shtrihej në disa vende, të përfshirë 51 persona

Goditen 7 grupe të strukturuar kriminale, 39 persona në pranga e 12 të tjerë në kërkim

Përgjatë 1 viti e gjysmë trafikuan 1.000 shqiptarë në SHBA, Angli, Irlandë dhe në Kanada



TIRANË

Shtatë grupe të strukturuar kriminale që trafikojnë emigrantë të paligjshëm janë goditur nga policia shqiptare në bashkëpunim me autoritetet në SHBA, Kanada, EUROPOL dhe INTERPOL. Gjatë megaoperacionit të koduar "One If-By Land", janë arrestuar 39 persona, mes të cilëve 4 efektive policie. Ndërsa janë shpallur në kërkim 12 të tjerë, në mes të cilëve 2 shtetas bullgarë. Nga kryerja e veprimeve hetimore ka rezultuar se grupet kriminale, të cilat operojnë në Shqipëri, Bullgari, Spanjë, Francë, Republikën Dominikane, Itali, Britani, Irlandë, SHBA e Kanada, në një periudhë prej një viti e gjysmë kanë mundur trafikimin e rreth 1 mijë personave (shtetas shqiptarë) në drejtim të Mbretërisë së Bashkuar, SHBA-ve dhe Kanadasë. Kjo kundrejt pagesës në euro dhe në dollarë. Burime zyrtare nga Policia e Shtetit dje bënë me dije se në këtë aktivitet kriminal janë përfshirë 51 persona dhe se po punohet intensivisht për vënien në pranga të shtetasve të shpallur në kërkim.

OPERACIONI

Drejtori i Policisë së Shtetit Ardi Veliu dje bëri me dije se përgjatë natës të së premtes dhe në orët e para të mëngjesit të djeshëm është përbyllur megaoperacioni i koduar "One If - By Land", në kuadër të goditjes së kontrabandimit të personave me qëllim emigrimin drejt SHBA-ve, Kanadasë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Sipas tij, i gjithë hetimi i zhvilluar me metoda speciale nga Policia e Shtetit, nën drejtimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe ka zgjatur disa muaj. Mësohet se operacioni i drejtuar nga prokurori Eguen Beci është zhvilluar në disa qytete të vendit tonë dhe konkretisht në: Tiranë, Lezhë, Kukës, Fier, Dibër, Shkodër dhe Korçë. Ndërkaq, Veliu pohoi se operacioni u realizua në koordinim me agjentët special të shërbimit Diplomatik të Sigurisë të Departamentit të Shtetit në SHBA që janë atashuar në Tiranë; agjencitë e Departamentit të Sigurisë Kombëtare dhe Patrullimit të Kufirit të SHBA-ve. Ndërsa, Dogana dhe Mbrojtja Kufitare-Qendra Kombëtare e Targetimit, janë dy agjencitë që kanë asistuar në zhvillimin e hetimeve dhe realizimin e këtij operacioni. Partnerë të tjerë që kanë asistuar dhe kontribuar në këtë operacion janë: Agjencia e Shërbimeve Kufitare të Kanadasë, SELEK, EUROPOL, Interpol, policia e Kosovës, policia kombëtare span-



Momenti i arrestimit të trafikantëve



Xhafaj: Operacioni u realizua me partnerët amerikanë e europianë

TIRANË - Pas goditjes së 7 grupeve kriminale, aktiviteti i të cilave shtrihej në disa shtetë me reaguar ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Ai tha se operacioni ku u arrestuan 39 persona në Shqipëri është zhvilluar me partnerët amerikanë dhe europianë. Përmes një reagimi në "Twitter", kreu i ministrisë së Brendshme theksoi se kjo ishte një goditje 7 në 1, ndërsa paralajmëroi aksione të tjera me rëndësi. "Një superaksion i finalizuar nga Policia e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese në vend. Goditje njëkohësisht e disa grupeve kriminale. 7 në 1. Shumë shpejt detaje të tjera nga Policia e Shtetit, dëshmi e forcës së ligjit dhe profesionalizmit në rritje të policisë, bashkëpunim i shkëlqyer me partnerët amerikanë dhe europianë, tregues i qartë i besueshmërisë ndaj Policisë së Shtetit. Forca e ligjit do të vazhdojë të ndëshkojë të tjera grupe kriminale", u shpreh ministri Xhafaj

MEGAOPERACIONI

PERSONAT E ARRESTUAR

1. Ardian CORRI, 47 vjeç, lindur në Krujë dhe banues në Tiranë.
2. Luan QYRKU, 60 vjeç, banues në Tiranë.
3. Eno MUÇOLLARI, 57 vjeç, banues në Tiranë.
4. Ardian GURAKUQI, 58 vjeç, lindur në Elbasan e banues në Tiranë.
5. Zaim HYSENBELLIU, 57 vjeç, lindur në Skrapar e banues në Tiranë.
6. Arben KAJAÇI, 49 vjeç, lindur e banues në Tiranë.
7. Genci OSMANAJ, 49 vjeç, lindur e banues në Tiranë.
8. Oltjan SERANI, 33 vjeç, lindur në Përmest e banues në Tiranë.
9. Tanush PRENGA, 48 vjeç, lindur në Krujë dhe banues në Laç.
10. Liri MUÇOLLARI, 55 vjeç, lindur në Çorovodë e banues në Tiranë.
11. Fuat ZAIMI, 51 vjeç, lindur në Skrapar dhe banues në Tiranë.
12. Nikolin PRISKA, 49 vjeç, banues në Tiranë.
13. Ylber RAMA, 44 vjeç, lindur në Dibër e banues në Tiranë.
14. Haki TARJA, 50 vjeç, banues në Tiranë.
15. Bedri BENDAJ, 55 vjeç, lindur në Berat, e banues Tiranë.
16. Erenik AVDYLLI, 30 vjeç, banues në Tiranë.
17. Nik BUSHI, 65 vjeç, lindur e banues në Shkodër
18. Kolë VUSHAJ, 49 vjeç, banues në Malësi të Madhe.
19. Besnik VUÇAJ, 49 vjeç, lindur në Shkodër, por rezident në Irlandë.
20. Alfred KALAJ, 32 vjeç, banues në Malësinë e Madhe.
21. Mhill ZEFI, 42 vjeç, banues në Shkodër.
22. Nosh VOLAJ, 45 vjeç, banues në Malësi e Madhe.
23. Prel GJELAJ, 54 vjeç, banues në Malësi e Madhe.
24. Sokol DULI, 49 vjeç, banues në Lezhë.
25. Euglen DUSHKU, 32 vjeç, banues në Lezhë.
26. Leonora DUSHKU, 33 vjeç, banuese në Lezhë.
27. Roza FRROKU, 40 vjeç, lindur në Fier e banuese në Lezhë.
28. Blerim BRAHIMI, 36 vjeç, banues në Lezhë.
29. Luigj SHTINJA, 52 vjeç, banues në Kurbini.
30. Esat CAKONI, 52 vjeç, banues në Kurbini.
31. Fatos MUJA, 48 vjeç, banues në Kukës
32. Kreshnik MUJA, 35 vjeç, banues në Kukës.

NË KËRKIM 12 PERSONA

33. Artur KARAJ, 43 vjeç, banues në Krujë.
34. Kristian Zallinaj, 21 vjeç, banues në Shkodër.
35. Mensur Selami, 53 vjeç, lindur e banues në Dubrovë - Peshkopi.
36. Çelnik MAKSUTI, 53 vjeç, lindur e banues në Pogradec me detyrë kontrollor në P.K.K.Qafë Thanë.
37. Ilir ISMAILI, 32 vjeç, lindur e banues në Pogradec, me detyrë kontrollor në P.K.K.Qafë Thanë.
38. Erjon MAXHARI, 28 vjeç, lindur e banues në Pogradec, me detyrë kontrollor në P.K.K.Qafë Thanë.
39. Gjokë UJKAJ, 46 vjeç, lindur e banues në Shkodër, me detyrë kontrollor në P.K.K. Hani i Hotit Shkodër.

U SEKUESTRUAN PROVAT MATERIALE

- Gjatë kontrollit të ambienteve dhe vendeve të dyshuara që përdorshin nga autorët, janë gjetur dhe sekuestruar disa prova materiale si:
- 10 njësi qendrore (kompjuteri)
 - 8 printerë lazer me ngjyra
 - 15 laptopë, 3 i-padë,
 - 56 aparate telefonash
 - 17 automjete
 - 5.600 euro, 1.000 \$ dhe 3.400.000 lekë
 - 5 pasaporta ndërkombëtare shqiptare
 - Sasi dokumentesh të ndryshme, si pasaporta e karta ID të kombësive të ndryshme, vula dhe elementë stampimi
 - 1 armë zjarri automatike model 56 dhe 13 fishekë
 - 1 armë gjahu

jolle, policia franceze, policia italiane, etj. Gjithashtu, kreu i Policisë së Shtetit tha se nga veprimet hetimore ka rezultuar 7 grupe të strukturuar kriminale, të cilat operojnë në vendin tonë dhe në disa vende të tjera kanë mundur trafikimin e

trabandimit e rreth 1 mijë shtetasve shqiptarë në drejtim të Mbretërisë së Bashkuar, SHBA-ve dhe Kanadasë. Lidhur me provat dhe faktet e grumbulluara me metoda speciale hetimi, Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë ka kërkuar në

Gjykata dhe ka nxjerrë Urdhra Ndalimi për 51 shtetas shqiptarë të implikuar, nga të cilët janë ekzekutuar 39 të tillë dhe 12 shtetas të tjerë janë shpallur në kërkim. Materialet hetimore në lidhje me ndalimin e këtyre personave dhe provat mate-

riale të sekuestruara, janë vënë në dispozicion të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Hetimet për këtë procedim penal vijojnë në lidhje me persona të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal.

OPOZITA REAGIMET

Kreu i PD shkon në Lezhë: Nuk mund të ketë drejtësi selektive

Lulzim Basha: Hetim jopolitik dhe transparent për Fran Frrokajn

"Po bëhet presion i madh politik për të mbyllur çështjen 'Tahiri'"

Kreu i PD-së, Lulzim Basha deklaroi dje, se për kryebashkiakun e Lezhës Fran Frrokaj hetimi të jetë i pavarur dhe jo politik. "Nuk mund të ketë drejtësi selektive. Nuk mund të ketë drejtësi, nëse Tahiri, Dako, Gjilnuri, Ahmetaj, Sejdiu dhe një grusht kryebashkiakësh të korruptuar dhe zyrtarë të lartë të korruptuar të kësaj qeverie nën akuzë për vepra të rënda penale, nuk do të dalin para drejtësisë", tha dje, kreu i PD-së, Lulzim Basha, në një deklaratë për median, pas takimit me deputetët e komisionit hetimor "Tahiri". "Sot dua t'u them të gjithë shqiptarëve se ne shpresojmë dhe urojmë që Fran Frrokaj të jetë i pafajshëm. Qëndrimi im dhe i Partisë Demokratike është i pandryshuar, të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit, nga qytetarët e thjeshtë tek politikanët më të lartë. Por ne kërkojmë që hetimi të jetë transparent, të jetë jopolitik dhe i paanshëm", tha Basha.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

Sipas tij, "Shqiptarët meritojnë një drejtësi të pastër dhe profesionale dhe jo një drejtësi të kapur dhe të ndikuar nga axhenda politike për drejtësi selektive të drejtuar ndaj një krahu politik në favor të një krahu tjetër". Pas kësaj deklaratë, Basha shkoi në Lezhë, ku pati takim me strukturat e PD-së atje, ndërkohë që në qytet pati protesta nga mbështetësit të Fran Frrokajt. Ditën e hënë pritet që të mbledhet për herë të parë komisioni hetimor për çështjen "Tahiri". Për këtë Basha tha: "Në rastin e Saimir Tahirit ra shteti, pushtuan së ekzistuar të gjitha institucionet ligjzbatuese në vend. Qëllimi i komisionit hetimor është të zbardhë çfarë ndodhi dhe pse ndodhi, për të mos lejuar kurrë më që shteti të kapet nga krimi dhe të kthehet në zgjatim të trafikantëve të drogës dhe të grupeve kriminale të krimit të organizuar. Ne do të hetojmë

si dhe pse ndodhi që e gjithë kupola e policisë u kthye në organizatë kriminale dhe askush në qeverisje nuk reagoi? Si dhe pse ndodhi që, me gjithë informimet e shumta për përfshirjen e Saimir Tahirit në trafikun e drogës, asnjë institucion shtetëror nuk e vuri atë para përgjegjësisë?".

Po ashtu sipas Bashës ky komision do të hetojë "si dhe pse ndodhi që vendi u mbulua me drogë sheshit dhe asnjë institucion shtetëror nuk reagoi dhe nuk bëri asnjë përpjekje për ta ndaluar?". "Paralelisht me punën e këtij komisioni, prokuroria duhet të bëjë punën e saj për të hetuar

grupin kriminal "Habilaj-Tahiri" dhe të gjithë policët dhe bashkëpunëtorët e tjerë politikë dhe jopolitikë të këtij grupi të rrezikshëm. Duhet ta bëjë në mënyrë të paanshme dhe të pandikuar. Po bëhet presion shumë i madh politik për të mbyllur çështjen "Tahiri", deklaroi Basha.

Deputeti i PD-së: Ish-kreu i PS shpenzoi 5mln euro në fushatë

Oerd Bylykbashi: Arta Marku të nisë hetimin e Tahirit për shitblerje vote

Deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi kërkoi dje, nga prokuroria e përkohshme, Arta Marku "të nisë hetimin e Saimir Tahirit, ish-kreu i PS për Tiranën, për veprën korruptive të shitblerjes së votës". "Habilajt deklaroi në dhjetor 2013 që Saimir Tahiri ka shpenzuar së paku 5 milionë euro në fushatë zgjedhore. Fushata zgjedhore para dhjetorit 2013 ishte ajo e zgjedhjeve të qershorit të atij viti. Në janar 2014, Habilajt deklaroi në shtetësi të masaker, janë blerë të gjitha votat. E nëse blen kaq shumë, edhe fiton. Këto de-



klarime janë të regjistruara në prokurorinë e Catania-s, në Itali", u shpreh dje, Bylykbashi. "Në fushatën e 2013 që përmendim Habilajt, PS e qarkut Tiranë më në krye Tahirin, kërceu nga 140.000 vota në 2011 në 199.000 vota

në 2013 për të rënë në 130.000 në 2015 (të gjithë e dinë që Saimiri nuk e hopenes Erionin dhe as gur për të çarë kokën nuk i jep, jo më para). Një kërcim i paprecedent me plot 59.000 vota që nuk kishte ndodhur kurrë më parë në Tiranë dhe askund tjetër që vetëm shitblerja e votës dhe përfshirja e bandave e justifikojnë. Të shohim a do ta hetojë prokuroria këtë korruption politik me paratë e krimit on-shore, vendali, apo është prokurore guasqë që aktivizohet vetëm me telefonatë të kryeministrit", tha Bylykbashi.



Gjatë një seance parlamentare

HETIMI

Komisioni për "Tahirin", Alibeaj: Do verifikojmë a u pengua prokuroria

Deputeti i Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj tha dje, se ngritja e Komisionit Hetimor për rastin e ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, dhe fenomenin e kultivimit të drogës në vend, është aksioni i parë politik që do zgjasë gjashtë muaj, e që PD angazhohet të zbardhë të vërtetën. Në emisionin "Kjo javë" me Nisida Tufën në "News24", deputeti demokrat thotë se këto dy çështje janë në interes të publikut, pasi fenomenin e kultivimit të drogës është zgjeruar ndjeshëm pas vitit 2013. Sipas Alibeajt, gjatë punimeve të këtij komisioni do të diskutohet nëse ka pasur pengesë të punës së prokurorisë për rastin "Tahiri". Duke përmendur ekstradimin e Nezar Seitit drejt Italisë, Alibeaj tha se një veprim i tillë u bë pengesë për hetimet e prokurorisë. Alibeaj tha se në komision mund të ftohet sërisht Saimir Tahiri, por edhe Basha e Berisha, sipas ecurisë së punës. "Nuk ka ndonjë të fshehtë të madhe për të kuptuar punën e komisionit hetimor. Objektivi i komisionit janë përcaktuar dy çështje kryesore, së pari, për fenomenin e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike. Ky fenomen ka pasur edhe mbështetje politike, madje një zhytje totale politike, siç është rasti i përfshirjes së ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri. Së dyti, pra është çështja e përfshirjes së ish-ministrit Tahiri. Komisioni hetimor nuk heton hetimet e prokurorisë, nuk e lejon ligji. Kushtetuta, ajo çka ne kemi interes është korrektesa ligjore, pra fakti: "A e kanë mbështetur apo e kanë penguar të drejtën për të hetuar të organeve të prokurorisë", u shpreh deputeti i PD.



NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 109 / 229 + 3 - 6, e llojit 'Apartament', zona kadastrale 3292, volumi 24, faqe 166, sipërfaqe totale 110, 5 m², në pronësi të AMARILDO NAÇO, me adresë: Selitë , Tiranë .
ÇMIMI 5.890.500 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 12.04.2018
 CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 7 / 392 - G8, e llojit 'Garazh', volumi 20 , faqe 143, zona kadastrale 8370, me sipërfaqe totale 19,94 m², në pronësi të SHOOËRISË "IN CO" SHPK, NUIS: J62410017G, me adresë: Rruga "4 Dëshmorët", Tiranë .
ÇMIMI 2.000 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 11.04.2018
 CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURINË NR. 2863-ND-1-43, E LLOJIT 'APARTAMENT', VOLUMI 55, FAQJE 73, ZONA KADASTRALE 8513, ME SIPËRFAQJE 67,81 M², NË ADRESËN: RRUGA "K. KERTUSHA", SHKALLA 1, KATI 7, DURRËS, NË PRONËSI TË SHITETASVE : Z. LUTFI GJYZELI DHE ZNJ. ENKELEJDA GJYZELI .
ÇMIMI 2.000.000 LEKË ", Data e zhvillimit të ankandit do jetë 11.04.2018 .
 CEL. 0684026666 ; 0693262866 .



Java vendimtare për Shqipërinë, kryeministri takon kreun e PE e Mogherinin

Hapja e negociatave, Rama e Bushati, të hënën në Bruksel

Eurodeputeti Sassoli: Të gatshëm të hapin negociatat me BE

Darina Tanushi

Më 17 prill, Komisioni Europian do të publikojë paketën e zgjerimit, e cila, sipas burimeve nga BE, pritet të njoftojë dorëzimin e rekomandimeve në Këshillin Europian për hapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Magedoninë, raporton ANSA. Pikërisht lidhur me perspektivën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, të martën, më 20 mars, në Bruksel, do të mbahet një konferencë me pjesëmarrjen e kryeministrit Edi Rama, ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati, së bashku me Presidentin e Parlamentit Europian, Antonio Tajani, përfaqësuesen e Lartë e BE, Federica Mogherini, e organizuar nga eurodeputeti David Sassoli.

ton negociatat, por kjo do të varet më pas nga vendimi i 28 vendeve anëtare të BE-së. "Ne do jemi përkrah Shqipërisë për ta ndihmuar të përgatisë anëtarësimin. Në mënyrë që vende të tjera të bashkohen me Bashkimin



Kryeministri Edi Rama me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati

TAKIMI

Të martën më 20 mars, në Bruksel, do të mbahet një konferencë me pjesëmarrjen e kryeministrit Edi Rama, ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati, së bashku me Presidentin e Parlamentit Europian, Antonio Tajani, përfaqësuesen e Lartë e BE, Federica Mogherini, e organizuar nga eurodeputeti David Sassoli.

European do të na duhet që të gjitha problemet, grindjet ndërmjet vendeve kufitare të jenë të zgjidhura deri në datën e anëtarësimit", tha Juncker, ndërsa ishte në Shqipëri, në kuadër të turit rajonal. Një nga prob-

lemet që mbetet ende për t'u zgjidhur është ai me Greqinë për një marrëveshje të re detare. Mbetet ende në pritje vendimi i Presidentit Ilir Meta për t'i dhënë qeverisë autorizimin për negociim.

ton negociatat, por kjo do të varet më pas nga vendimi i 28 vendeve anëtare të BE-së. "Ne do jemi përkrah Shqipërisë për ta ndihmuar të përgatisë anëtarësimin. Në mënyrë që vende të tjera të bashkohen me Bashkimin

Largime pati edhe në Elbasan, Fier e Gjirokastrë

4 këshilltarë të LSI në Vlorë kalojnë me PS: LSI mbrojti PD për lobimin rus

Pas largimit të disa këshilltarëve në Elbasan, Fier e Gjirokastrë, dje u larguan 4 këshilltarë të LSI-së drejt PS-së, në qytetin e Vlorës. Këshilltarët e larguar nga LSI janë: Artimida Luci, Romana Jaho, Shkëlqim Leskaj dhe Bashkim Begaj. Ata deklarojnë se LSI e ka humbur orientimin si forcë që synonte integrimin në BE, pasi po justifikon lobimin rus të PD. "Zgjedhjet e fundit në pushtetin lokal si pjesë e koalicionit me PS, synonin mbrojtjen e interesave të qytetarëve. E ardhmja e Shqipërisë është integrimi në BE, konstatojmë me keqardhje se LSI ka humbur integritetin e saj dhe nuk mbron më interesat e



njerëzve të thjeshtë, por personale të drejtuesve dhe ish-funksionarëve të lartë të saj", thuhet në deklaratën e të larguarve. "LSI ka konsoliduar një aleancë të dyshimtë duke marrë në mbrojtje një forcë politike të zhytur në interesa të errëta antikombëtare, që ka lidhje me rusët. Eksponentët e LSI nuk janë distancuar, përkundrazi janë përpjekur t'i justifikojnë. Duke qëndruar besnikë të parimeve për të cilat kërkuan votën, e kemi të pamundur të vazhdojmë dhe largohemi nga LSI. Nga tani do të jemi pjesë e grupit të PS në Vlorë"-deklaroi

Deputeti i LSI-së në Vlorë, Shezai Rrokaj reagoi dje, duke thënë: "Vlorën as nuk e blejnë e as nuk e nënshtrijnë dot Edi Rama dhe Damian Gjiknuri! Edi Rama dhe Damian Gjiknuri po e bëjnë në mënyrë të hapur presion të këshilltarët me mbajtjen e vendit të punës. Këta këshilltarë prej disa muajsh nuk ishin më pjesë e grupit të LSI-së.

Shezai Rrokaj

Deputeti i LSI-së në Vlorë, Shezai Rrokaj reagoi dje, duke thënë: "Vlorën as nuk e blejnë e as nuk e nënshtrijnë dot Edi Rama dhe Damian Gjiknuri! Edi Rama dhe Damian Gjiknuri po e bëjnë në mënyrë të hapur presion të këshilltarët me mbajtjen e vendit të punës. Këta këshilltarë prej disa muajsh nuk ishin më pjesë e grupit të LSI-së.



Lobimi rus, Balla: Basha të merret i pandehur, të marrë përgjegjësitë

Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, njëherësh edhe Sekretar i Përgjithshëm, Taulant Balla deklaroi dje, se Lulzim Basha duhet të merret i pandehur nga prokuroria. Duke folur sërisht për financimet ruse, Balla tha se "Basha nuk arrin dot t'i përgjigjet disa pyetjeve të thjeshta: Së pari, si shpjegohet që Lulzim Basha thotë se i ka paguar lobuesit të tij në Washington vetëm 25 mijë dollarë, ndërsa kompania lobuese Muzin, që ka firmosur kontratë me Lulzim Bashën, deklaroi se ka marrë plot 525 mijë dollarë nga Partia Demokratike?! Nga kanë dalë gjysmë milion dollarët shtesë? Ku i ka gjetur Lulzim Basha gjysmë milion dollarët ekstra? Përse nuk i deklaroi në KQZ si shpenzime të fushatës zgjedhore, siç parashikohet ligji shqiptar?" Balla erdhi një sërë pyetjesh për kreun e PD-së për të ditur dhe shpjeguar shqiptarëve se cili është burimi i këtyre parave apo cila është lidhja e vërtetë mes Lulzim Bashës dhe biznesmenëve rusë që kanë në pronësi firmën Biniatta, e që kanë paguar plot 150 mijë dollarë të tjera kompanisë lobuese Muzin?! "Sa kohë në kontratën e deklaruar nga vetë lobisti në Departamentin Amerikan të Drejtësisë është firma dhe numri i pasaportës së Lulzim Bashës, i takon prokurorisë ta thërrasë një orë e më parë Lulzim Bashën për të dhënë shpjegimet e nevojshme si personi kryesor i dyshuar për një sërë veprash penale, e për ta zbardhur një orë e më parë këtë skandal tepër të rëndë. Lulzim Basha dhe Partia Demokratike duhet të marrin të gjithë përgjegjësinë për financimin e paligjshëm në kohën e "cadres së Republikës së Re", tha Balla. Sipas tij, burimet e errëta të këtij financimi, ku përfshihen edhe xhepa oligarkësh rusë, janë një arsye e pashmangshme që Lulzim Basha të ndiqet penalisht.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. Automjetit tip 'SKODA', ngjyrë 'GRË', vit prodhimi '2009', nr. shasje TMBDG41U4A8840601, me targë 'TR 2338 T', në pronësi të dorëzantit z. ALKET SUAD KOTONI, ÇMIMI 120.000 LEKË;
B. Automjetit tip 'HYUNDAI', ngjyrë 'GRË', vit prodhimi '2009', nr. shasje MALAM51CBAM416903, me targë 'AA 714 BH', në pronësi të dorëzantit znj. AIDA LUAN KOTONI, ÇMIMI 130.000 LEKË.
Data e zhvillimit të ankandit do jetë 21.03.2018.
CEL. 0684026666; 0693226286

Shoqëria Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së palaujtshme:

Pasurisë me Nr. 7/34, e llojit 'Apartament', me sip. 50.2 m², dhe sip.truall 19 m², ndodhur në Q. Memaliaj, Tepelenë ZK-2646, në pronësi të Skënder Feta Muka. Çmimi fillestar në ankandin e parë është 537,124.64 Lekë.
Ankandi zhvillohet në datë 19.03.2018, ditën e Hënë ora 15.30 në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për më shumë info. Tel:044503458 ose E-mail shoqeria@permbarimoreafa2010@gmail.com

NJOFTIM ANKANDI

Përmbasues gjyqësor privat Arina Sima zhvillon ankandit sipas datave të mëposhtme:
Date 16/04/2018, ditën e Hënë, ora 16:00, përfundon ankandit i ri (i dytë), për shitjen e pasurive të palaujtshme të llojit "Ara" me sip. 7400 m², e ndodhur në fshatin Bëlnçe Devoll, në vlerën 414,400 leke. Pasuritë janë lene garanci bankare nga debitori Trashëgimtareve të të ndjerit/Debitor znj. Bukurije Sulejman Fezo, znj. Mimoza Fatmir (Foto) Fezo, z. Xhami Foto Fezo, znj. Arkonnda Foto Fezo, znj. Eliverta Foto Fezo, znj. Luiza Foto (Kasabelli) Fezo baines ne fshatin Bëlnçe, bashkia Devoll, per detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me sell ne ish Blloku Tiranë.
Ankandit zhvillohet prane zyres se permbasuesit me sell lagjen nr.3, Rruga Avni Rustemi, nr.31, k.1, Korçe. Kontakti Cel.0674044666, e-mail. simaarina@yahoo.com

Presidenti, folës kryesor në panelin për Ballkanin në Forumin e Baku-t

Darina Tanushi

Meta: Projekti europian, pa zgjerimin e BE-së në Ballkan, punë e papërfunduar

"Çdo vonesë në integrim do të shfrytëzohet nga të tjerët"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta deklaroi dje, në forumin e 6-të të Baku-t në Azerbajxhan se "destinacion final i vendeve të Ballkanit është BE". Gjatë fjalës që mbajti në panelin kryesor të forumit, Meta tha: "Padyshim ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për të realizuar reformat e nevojshme, por edhe BE duhet të jetë më e vendosur dhe më e qartë në mbështetje të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Strategjia e re e zgjerimit të BE-së duhet të shoqërohet me veprime konkrete. Çdo hezitim dhe çdo vonesë, apo vakum, do të plotësohet nga faktorët e tjerë, të cilët do të përpiqen të shfrytëzojnë frustrimin e njerëzve".

Si folësi kryesor, në panelin e veçantë dedikuar Ballkanit në Forumin e 6-të Global të Baku-së me temë: "E tashmja dhe e ardhmja e Ballkanit - bosht i sigurisë rajonale apo një fushë e re shahu gjeopolitik", Meta theksoi se projekti ynë i përbashkët, pavarësisht ndasive dhe konflikteve të së kaluarës, është integrimi në Bashkimin Evropian.

"E ardhmja e përbashkët e qytetarëve tanë në Ballkan, varet nga vetë vendet tona, nga aftësia jonë për t'iu përgjigjur sfidave të së ardhmes me më shumë zhvillim dhe prosperitet për popujt tanë" - nënvizoi Presidenti Meta. Gjithashtu, Presidenti Meta theksoi se "projekti evropian, pa zgjerimin e plotë të BE-së në rajonin e Ballkanit, është një punë e papërfunduar. Paqja, stabiliteti dhe siguria e rajonit të Ballkanit nuk mund të merret e mirëqenë. Rajoni ynë në të shkuarën ka përjetuar luftëra të përgjakshme sa herë që ka shërbyer si fushë beteje për interesat e fuqive të mëdha." Në fjalën e tij Presidenti Meta u ndal edhe në projektin madhor TAP, duke theksuar se "Realizimi i gajzjellësit TAP është një kontribut jo vetëm për stabilitetin dhe sigurinë rajonale, por edhe me impakt strategjik për interesat ekonomike dhe të sigurisë energjetike të vetë BE-së". Duke iu referuar çështjeve të sigurisë, Presidenti Meta, nënvizoi se zgjerimi i NATO-s me vende si, Mali i Zi dhe potencialisht Maqedonia, dëshmon për një vullnet dhe mbështetje solide e të qartë të Aleancës dhe veçanërisht të SHBA-së për rajonin e Ballkanit. Presidenti Meta nënvizoi në fjalën e tij se fatkeqësisht, sfidat e përditshme ekonomike të vendeve tona në epokën aktuale të globalizimit po frymëzojnë valë të reja të emigrimit masiv drejt BE-së, sidomos mes të rinjve të kualifikuar. Kjo "hemorragji e trurit" drejt Europës po krijon pa-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta deklaroi dje, në forumin e 6-të të Baku-t në Azerbajxhan

soja shqetësuese për të ardhmen e shoqërive tona - theksoi Presidenti Meta. Lidhur me zhvillimin e rajonit, Presidenti Meta, vlerësoi se Ballkani ka qenë ndër shekuj

dhe do të jetë "një lidhëse" e Lindjes me Perëndimin, duke shtuar se, ne inkurajojmë dhe mirëpresim investime nga të gjitha fuqitë emergjente ekonomike.

TAKIMI

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, në kuadër të pjesëmarrjes në Forumin e 6-të Global të Baku-së, u takua me Presidentin e Republikës së Moldavisë, zotin Igor Dodon. Presidenti Meta vlerësoi marrëdhëniet e mira e miqësore midis dy vendeve, si dhe shprehu interesin për të intensifikuar marrëdhëniet me Moldavinë, veçanërisht në kuadër të bashkëpunimit ekonomik e tregtar.

Natyrisht ato nuk mund të përplasen me axhendën tonë të përbashkët Euro-Atlantike dhe me aspiratat demokratike të qytetarëve tanë.

LSI

Vasili akuzon Ramën: Goditi të varfrit, u hoqi ndihmën ekonomike

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili ka akuzuar sërish dje, kryeministrin Rama se godet të varfrit. Ai i referohet raportit të BB, sipas të cilit "reforma e energjisë elektrike dëmtoi të varfrit" dhe akuzon Ramën se rri e vështron përballë kësaj situatë. "Banka botërore thotë që reforma e energjisë elektrike dëmtoi të varfrit dhe kryeministri rri e vështron. Ja çfarë thotë Banka Botërore: "Arkëtimet më të larta të energjisë mund të kenë pasur efekte negative tek familjet më të varfra për shkak se një pjesë e madhe e tyre kishin detyrime të paguara si dhe pesha e buxhetit që këto familje paguajnë për energjinë është më e madhe se familjet e tjera, respektivisht 7 për qind", thuhet në raportin e Bankës Botërore", citoi Vasili. Sipas tij, "të varfrit goditen dhe nuk mbrohen fare nga qeveria. Ndiha ekonomike u hiqet pa iu dridhur dora mijëra të varfërve nga qeveria. Minimumi biologjik thënë thjesht fare minimumi i ushqimit ditor për mijëra shqiptarë nuk sigurohet nga qeveria. Nuk ulet TVSH e artikujve të shportës thënë thjesht ushqimeve bazë për mbijetesë, por është katër herë më e lartë se vendet më të fuqishme e të pasura të Europës", tha Vasili.



Ambasadorja e BE-së kundërshton idenë e kufirit pa dogana

Vlahutin në Morinë: Shqipëria e Kosova, pa dogana, kur të jenë pjesë e BE-së

Ambasadorja e Bashkimit Europian në Shqipëri, Romana Vlahutin është shprehur kundër ideve apo projekteve për një kufi pa dogana mes Shqipërisë dhe Kosovës para anëtarësimit të dy vendeve në BE. Shefja e Delegationit të Bashkimit Evropian e dha këtë mesazh nga pika kufitare e Morinës, ku inspektori ecurin e punimeve për doganën e përbashkët, se Shqipëria dhe Kosova do të jenë pa dogana vetëm kur të jenë anëtare të BE-së. "Në momentin që të dyja shtetet do të jenë anëtare të Bashkimit Europian nuk do të ketë dogana mes tyre ashtu siç nuk do të ekzistojnë doganat ndërmjet këtyre vendeve dhe vendeve të tjera anëtare", u shpreh Romana Vlahutin. Projekti i BE-së për modernizimin e pikës kufitare Morinë - Vermicë është drejt përfundimit. Dogana e përbashkët do të lehtësojë lëvizjen nga të dy krahët, jetën e përditshme të banorëve të zonës dhe do të ndihmojë në mbështetje të investimeve të reja. Ndërsa në lidhje me hapjen e negoci-



atave, Vlahutin u shpreh se në prill do nisë vlerësimin nga shtetet anëtare të BE e që do përmbyllet me një raport në

qershor duke shpresuar që do të jetë një raport pozitiv. "Do të ketë një paketë në muajin prill, që do të bëhet një vlerësim. Më pas në qershor të gjitha shtetet do të bëjnë vlerësimin e tyre dhe do të marrin një vendim. Shpresoj për më të mirën", tha ambasadorja e BE-së, në Tiranë. Në këtë vizitë pikëkalimin kufitar të Morinës, Vlahutin shoqërohej nga drejtoresha e Përgjithshme e Doganave të Shqipërisë, Belinda Ikonomi kreu i Doganave të Kosovës, Bahri Berisha, si dhe zyrtarë të lartë të Policisë Kufitare nga të dy vendet.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

*Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvilloi ankandin e trette për shitjen e pasurive të paluajtshme:

1. Apartamenti me Nr. pasurie 118/57+2-10, ZK 3292, vol 38, faqe 184, me sipërfaqe 94.5 m², të ndodhur në Selitë, Tiranë;
2. Apartamenti me Nr. pasurie 118/57+2-11, ZK 3292, vol 38, faqe 185, me sipërfaqe 99 m², të ndodhur në Selitë, Tiranë,

per shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorit Shoqëria "EDIL-AL-IT" Sh.p.k. në shumat 67'927(gjeshhtëdhjetë e shtatë mijë e nentëqind e njëzetë e shtatë)Euro dhe 309'225(treqind e nëntë mijë e dyqind njëzetë e pesë) Leka.

Çmimet me të cilat fillon ankandin i trette janë në vlerat:

1. Apartamenti me nr. pasurie 118/57+2-10, ZK 3292, vol 38, faqe 184, me sipërfaqe 94.5 m², të ndodhur në Selitë, Tiranë, në shumën 40'484(dyzetë mijë e katerqind e tetëdhjetë e kater)Euro;
2. Apartamenti me nr pasurie 118/57+2-11, ZK 3292, vol 38, faqe 185, me sipërfaqe 99 m², të ndodhur në Selitë, Tiranë, në shumën 41'983(dyzetë e një mijë e nentëqind e tetëdhjetë e tre)Euro;

Ankandi i trette zhvillohet në datë 03.04.2018, ora 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", Qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.0682099471, 0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarim.com.*



Deputeti i PD, 8 propozime për statutin: Drejtuesit të marrin pastërtinë e figurës

Deputeti demokrat Myllim Murrizi ka bërë publike rreth 8 propozime të tij për ndryshime në statutin e Partisë Demokratike. Ai propozon që "kryetar sisioni, kryetar grupseksioni, kryetar dege, dhe kryetari i PDSH të zgjidhen nga parimi një anëtar - një votë, ndërsa kandidatët për kryetar bashkie dhe për deputetë duhet t'i nënshtrohen votës së anëtarëve të PD". Një tjetër propozim i tij është se të gjithë kandidatët për të qenë drejtues nga kryetar dege, anëtarë të këshillit kombëtar, anëtarë të kryesisë së madhe, drejtues departamentesh, kandidatët për kryetar bashkie dhe kandidatët për deputetë duhet të marrin patjetër pastërtinë e figurës së tyre tek autoriteti i dosjeve të sigurimit. "Kush ka qenë spiun nuk duhet të jetë më drejtues i demokratëve, u shpreh ai dje. Sipas tij, kryesia qendrore e PDSH të jetë funksionale dhe jo më shumë se 23-25 anëtarë, të cilët duhet të zgjidhen nga kuvendi kombëtar dhe jo nga këshilli kombëtar. Sekretari i përgjithshëm, sekretari organizativ dhe 2 nënkryetarët të zgjidhen nga kuvendi kombëtar, që të jenë persona politikë me mbështetje sa më të gjerë të anëtarësisë", -tha Murrizi.

**PRONAT
DOSJET**

Onela Manjani

Ish-pronarët që janë të prirje të vendimeve të Agjencisë së Trajtit të Pronës për njohjen dhe kompensimin e pronës mund të marrin informacion përmes portalit qeveritar e-albania. Së fundi në këtë portal janë shtuar shërbimet për kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes, kërkesë për ndryshimin e specialistit që shqyrton dosjen dhe procedurat për shqyrtimin e dosjes. Kërkesa për këtë të fundit plotësohet përmes një formulari që është publikuar në portalin e-albania. Shërbimi elektronik "Ankesë dhe trajtim i dosjes me specialistin përkatës pranë ATP" u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë online kërkesën për takime ose ankesa në lidhje me shqyrtimin e dosjeve të ndjekura nga Agjencia e Trajtit të Pronave (ATP). Pas dërgimit të aplikimit, specialisti i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun pranë ATP, bën shqyrtimin e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues, nëse ka. Në rastin kur kërkesa është e rregullt, specialisti përpilon përgjigjen për kërkesën e aplikantit dhe ia dërgon me e-mail si dhe tek "Hapësira ime" në seksionin "Dokumentet e mia" në e-albania. Nëse përgjigja është kërkuar edhe në formatin letër, atëherë ai njoftohet se duhet të paraqitet pranë Agjencisë së Trajtit të Pronave për ta tërhequr atë. Në rastin kur aplikimi nuk është i rregullt dhe nuk pranohet, aplikanti njoftohet për këtë fakt me anë të e-mail.

DOSJET ME PROBLEME

Shërbim elektronik "Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes" u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë online kërkesën për të marrë informacion në lidhje me ecurinë e shqyrtimit të dosjeve të ndjekura nga Agjencia e Trajtit të Pronave (ATP). Pas dërgimit të aplikimit, specialisti i zyrës Juridike, pranë ATP-së, bën shqyrtimin e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues nëse ka. Në rastin kur kërkesa është e rregullt, specialisti përpilon përgjigjen për kërkesën e aplikantit dhe ia dërgon me e-mail, si dhe tek "Hapësira ime" në seksionin "Dokumentet e mia" në portalin e-albania. Nëse përgjigja është kërkuar edhe në formatin letër, atëherë ai njoftohet se duhet të paraqitet pranë Agjencisë së Trajtit të Pronave për ta tërhequr atë. Në rastin kur aplikimi nuk është i rregullt dhe nuk pranohet, aplikanti njoftohet për këtë fakt me anë të e-mail.

Aplikimi për ankesë dhe trajtim i dosjes me specialistin përkatës kryhet në e-albania

Pronarët, procedurat e reja për kërkesat dhe ankesat në ATP

Dokumentet dhe kostot për statusin dhe shqyrtimin e dosjes



Formulari për kërkesat e pronarëve

"ANKESË DHE TRAJTIM I DOSJES ME SPECIALISTIN PËRKATËS PRANË ATP"

- DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM**
- Dokument identifikimi; kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portal)
 - Formulari i aplikimit për takime dhe ankesa
 - Dokumentacion shtesë, nëse është e nevojshme
- HAPAT E PROCEDURËS**
- Logohuni si qytetar në portalin e-albania
 - Zgjidhni shërbimin "Ankesë dhe trajtim i dosjes me specialistin përkatës pranë ATP"
 - Plotësoni të dhënat e formularit, duke bashkëngjitur dhe dokumente plotësuese nëse është e nevojshme.
 - Klikoni butonin "Dërgo"
 - Specialisti i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun bën shqyrtimin e aplikimit dhe përpilon përgjigjen duke ia dërguar aplikantit të nënshkruar në mënyrë dixhitale ose me postë në hard copy, në varësi të kërkesës së aplikantit.
- KOHA E NEVOJSHME PËR MARRJEN E SHËRBIMIT** 30 ditë

"KËRKESË PËR STATUSIN DHE PROBLEMATIKAT E SHQYRTIMIT TË DOSJES"

- DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM**
- Dokument identifikimi; kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portal)
 - Formulari i aplikimit për informim në lidhje me ecurinë e dosjes
 - Dokumentacion shtesë, nëse është e nevojshme

HAPAT E PROCEDURËS

- Logohuni si qytetar në portalin e-albania
- Zgjidhni shërbimin "Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes"
- Plotësoni të dhënat e formularit, duke bashkëngjitur dhe dokumente plotësuese nëse është e nevojshme
- Klikoni butonin "Dërgo"
- Specialisti i zyrës Juridike bën shqyrtimin e aplikimit dhe përpilon përgjigjen duke ia dërguar aplikantit të nënshkruar në mënyrë dixhitale ose me postë në hard copy, në varësi të kërkesës së aplikantit

KOHA E NEVOJSHME PËR MARRJEN E SHËRBIMIT 30 ditë

Kostoja e shërbimit 3 mijë lekë

Shqyrtimi i dosjeve në ATP, afatet dhe dokumentet



ishtë të vullosura me vullën e gjykatës dhe të shoqëruar me akt ekspertimitin përkatës, në rast se gjatë gjykimit të çështjes është kryer një i tillë dhe dokument që vërteton shpronësimin, shtetëzimin apo konfiskimin e pronës së subjektit të shpronësuar; sipas aktve ligjore e nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose në çdo mënyrë tjetër të padrejtë që nga data 29.11.1944; apo dokumenti për pasuritë e paluajtshme të shtetasve shqiptarë të krijuara para datës 7 prill 1939, të cilat janë sekuestruar sipas nenit 14 të ligjit nr. 37, datë 13.01.1945 "Ligji i tatimit të jashtëzakonshëm për

fitimet e luftës", si dhe dokument e lëshuara nga Arkivi i Shtetit dhe Hipoteka.

HAPAT E PROCEDURËS

Subjekti i shpronësuar depoziton, drejtpërdrejt ose me postë, në ATP kërkesën për njohjen/kthimin apo kompensimin e pronës, shoqëruar me dokumentacionin e lartpërmendur. Kërkesa e subjektit të shpronësuar duhet të jetë sipas formularit tip, të miratuar nga ministri i Drejtësisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së, (ky formular gjendet në website-in zyrtar të ATP-së). ATP-ja pranohet dhe administron kërkesat e subjekteve të shpronësuar kundrejt tarifave të përcaktuara, me urdhër të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Financave. Në

rastet kur ATP-ja konstaton mungesë në dokumentacion, subjektit të shpronësuar i kërkohet plotësimi i dosjes përkatëse, brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes së njoftimit për plotësim dokumentacioni. Dosja/kërkesa qëndron në sektorin e shqyrtimit deri në plotësimin e plotë të dokumentacionit ligjor dhe teknik të kërkuar, por jo më shumë se 30 ditë nga dita kur subjekti titullar i dosjes ka marrë dënimin për mangësitë e saj. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të sipërcituar, propozohet marrjen e një vendimi në gjendjen që janë aktet. Të gjitha kërkesat për njohje dhe kthim të pronës, në zyrat e ATP-së shqyrtohen sipas rendit kronologjik të paraqitjes së tyre në ish-ZRRKP apo ATP Tiranë. ATP-ja, pas shqyrtimit të kërkesës merr një vendim për dosjen/kërkesën për pranimin/rëzimin e plotë/e pjesëshëm të saj.

Financimet e hidrocentraleve, kryeson BERZH me 61 projekte

Studimi, 29 HEC-e në zona të mbrojtura në gjithë vendin

Banka dhe financime miliona euro për ndërtimet e impianteve

Ornela Manjani

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim është financuesi më i madh i hidrocentraleve në Ballkan, duke mbështetur një total prej 61 impiantesh me 126 milionë euro, 29 prej tyre brenda zonave të mbrojtura, ose zonave të rrezikuara të biodiversitetit të pranuar ndërkombëtarisht. Në këtë përfundim arrin një studim i CEE Bankwatch Network, i cili mbulon Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi, Serbinë dhe Slloveninë. Sipas studimit, megjithëse banka ka qenë më e kujdesshme vitet e fundit, ende po konsideron financimin e impianteve të reja edhe në vendin tonë.

FINANCIMET

BERZH është banka udhëheqëse ndërkombëtare që administron një studim mjedisor dhe social për



Foto ilustruese

kaskadën e Skavicës, çka sipas autorëve të studimit do të thotë se kjo bankë mund të financojë hidrocentralin nëse studimet tregojnë se projekti mund të bëhet sipas standardeve të saj, ndërsa kredia do të jetë së paku 202 milionë euro. Studimi, gjithashtu, zbulon edhe investimin më të madh të një banke tregtare në Ballkanin Perëndimor, një hua prej 178 milionë euro nga banka turke IsBank për Aven

Enerji për kaskadën e lumit Fan. Ky projekt u shoqërua nga një sërë konfliktesh të dhunshme me komunitetet lokale. Duke pasur parasysh se e njëjta kompani projekti është e përfshirë në projektet Poçem dhe Kalivac në luginën e Vjosës, kjo ngre shqetësime se financuesit turq do të përshihen edhe në këto projekte, dhe, për shkak të mungesës së transparencës dhe standardeve mjedisore e sociale,

do të injorjnë shkatërrimin e ekosistemeve jetike të Vjosës. Ndërkaq, sipas autorëve të studimit, financuesit duhet të marrin pjesën e tyre të përgjegjësisë dhe të sigurojnë pajtueshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, pasi vendimet e investimeve të pakujdesshme mund të shkatërojnë qindra lumenj të pacenuar të Ballkanit në mënyrë të pakthyeshme.



Inceneratori i Elbasanit

Gjijknuri: Ka nevojë për më shumë mbetje, të merren masa

Ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, Damian Gjijknuri ka inspektuar impiantin e djegies së mbetjeve me prodhim energjie në qarkun e Elbasanit, ndërsa i ka kërkuar qeverisë dhe autoriteteve lokale të trajtojnë në terma afatgjatë nevojën për mbetje. Kjo pasi, aktualisht, në këtë impiant deponizojnë mbetjet e tyre urbane pa pagesë Bashkia e Elbasanit, ajo e Cërrikut dhe disa njësi administrative në qark. Ndërkohë që kapaciteti i tij është më i madh dhe është llogaritur të mbulojë mbetjet e të gjitha bashkive të qarkut Elbasan. "Kuptohet, impianti ka nevojë për më shumë mbetje dhe kjo është një çështje që duhet ta trajtojë bashkitë, por edhe qeveria në terma afatgjatë, pasi problemi i mbetjeve do të jetë një problem serioz për Shqipërinë. Ajo çka duhet tu imponojmë qytetarëve por edhe autoritetëve që duhet të marrin masat është që mbetjet të grumbullohen aty ku duhet të grumbullohen dhe të deponizohen në këtë impiant që ka edhe anën tjetër pozitive që prodhon energji elektrike. Këtu sot u njoha edhe me parametrat e prodhimit të energjisë elektrike dhe ka një funksion të shtuar për publikun, pasi energjia që çlirohet kthehet në energji elektrike dhe kontribuon në rrjetin elektroenergjetik". Ministri sqaroi se një impiant i tillë është duke u ndërtuar në Bashkinë e Fierit ndërsa edhe kryeqyteti do të ketë një impiant për të trajtuar mbetjet e veta urbane. Ndërkohë që, ftoi skeptikët të shohin nga afër investimin e Elbasanit.

PROBLEMI

Impianti ka nevojë për më shumë mbetje dhe kjo është një çështje që duhet ta trajtojë bashkitë, por edhe qeveria në terma afatgjatë, pasi problemi i mbetjeve do të jetë një problem serioz për Shqipërinë.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

ALAS



21-vjeçarja shpërthen në lot: Më jepni një kartë telefoni

Helmoi vjehrrën me fostoksinë, Marjana Cmeta takon vajzën 6 muajshe në burgun e grave

TIRANË - Marjana Cmeta, e cila afro një vit më parë helmoi me fostoksinë vjehrrën e saj, Lirije Lami është transferuar në burgun e grave "Ali Demi" në kryeqytet. Mësohet se dy ditë më parë, 21-vjeçarja është takuar me prindërit e saj, të cilët i kanë çuar për ta parë foshnjën e saj 6-muajshe. Burime pranë burgut konfirmuan se e reja ndodhet në gjendje të rënduar psikologjike, ndërsa ka shpërthyer në lot në momentin e takim-

it me të bijën. Edhe pse me një peshë të rëndë mbi supet, Marjana ka marrë në krahët e saj foshnjën, e ka puthur përqaftuar e ushqyer me gjalpë por pas 1 ore ato të dyja janë ndarë. Foshnja, të cilës Olti Lami nuk i ka dhënë ende atësinë dhe është ende i pavendosur nëse do ta bëjë një ditë, është marrë nga gjyshërit, prindërit e Marjanës. Teksa ndodhej në qeli, punonjësit e burgut e kanë sqaruar të akuzuarën për ngjarjen e rëndë se ligji e lejon të rriste foshnjën bren-

da këtyre ambienteve, por Marjana është shfaqur e pavendosur. Ajo ka kërkuar kohë, ndërsa ua ka besuar të voglën prindërve. Të njëjtat burime, thanë se e Marjana Cmeta nuk është lënë në një qeli të veçantë, për të shmangur ndonjë tentativë të mundshme vetë-vrasjeje. Për momentin ajo ka kërkuar vetëm një kartë telefoni që të mund të pyesë për të bijën. Krimi i kryer afro një vit më parë nga nusia 21-vjeçare, u zbulua falë këmbënguljes së Oltit, ish-



21-vjeçarja Marjana Cmeta

bashkëshortit të saj, i cili zbuloi videon që kishte regjistruar hoxha, Hysen Shehu, tek i cili nusja shatzenë rreth me detaje se si e helmoi vjehrrën e saj 48-vjeçare. Ndonëse nuk jetonte me të, Marjana ishte e bin-

dur që kjo e fundit i kish bërë magji dhe vendosi ta vrasë. Bëhet fjalë për një rrëfim 72 minutësh, video e cila i shërbeu prokurorisë për të ngritur akuzën "Vrasje për shkak të rrethanave familjare" ndaj Marjana Cmetës.

Banorët: Sherri për pronat, autori fillimisht e qëlloi me pistoletë

Masakroi kushëririn me sëpatë në kokë, arrestohet 40-vjeçari

Babai i viktimës: Im bir ishte me djalin e tij 7 vjeç kur u vra

VLORE

Një 37-vjeçar nga Vlo ra është masakruar me sëpatë nga kushëri pas një konflikti për motive pronësie. Trupi i pa jetë i Adem Veshajt u gjet rreth 500 metra larg banesës së tij. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qarqi bënë me dije se ngjarja e rëndë ndodhi mëngjesin e djeshëm në fshatin Gumenicë. Menjëherë pas sinjalizimit për vrasjen, blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë arrestuar autorin e krimit Dilaver Veshajn. 40-vjeçari akuzohet për veprën penale "Vrasje me dashje". Ndërkaq, babai i viktimës ka deklaruar se fillimisht autori e ka qëlluar me armë djalin e tij dhe më pas e ka goditur atë disa herë me sëpatë në kokë duke e lënë të vdekur. Gjithashtu, i ati i 37-vjeçarit ka thënë se vrasja është kryer në sy të nipit të tij 7-vjeçar (djali i viktimës).

VRASJA

Rreth orës 07:00, Adem Veshaj ka qenë duke shkuar për në fermën e tij të dhive, kur është përballuar në rrugë me kushëririn Dilaver Veshajn. Mësohet se fillimisht dy kushërinjtë kanë debatuar ashpër me njëri-tjetrin. Më pas sherri ka degjeneruar deri në vrasjen e 37-vjeçarit. "Më datë 17.03.2018, strukturat policore të DVP Vlorë kanë marrë njoftim se në fshatin Gumenicë, gjendet i pajetë rreth 500 m larg banesës së tij shtetasi A.V., 37 vjeç. Si rezultat i një punë të mirëorganizuar dhe bashkëpunimi ndërmjet DVP Vlorë, Delta Forcë, është bërë e mundur zbardhja e ngjarjes dhe kapja në kohë rekord e autorit, Dilaver Veshaj, 40 vjeç, banues në fshatin Gumenicë. Nga veprimet hetimore paraprahe dyshohet se të dy shtetasit janë konfliktuar me njëri-tjetrin për motive të dobëta, dhe më pas autori Dilaver Veshaj e ka goditur disa herë në kokë me mjet prerës (sëpatë), shtetasin A.V., i cili për pasojë



40-vjeçari i arrestuar, Dilaver Veshaj

ka ndërruar jetë. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes", thuhej në njoftimin zyrtar të policisë. Por, pas ngjarjes banorët e fshatit Gumenicë pohuan për "Gazeta Shqiptare" se ngjarja ndodhi për motive

pronësie. "Dy kushërinjtë ziheshin me njëri-tjetrin për punë pronash. Dilaveri e qëlloi me pistoletë Ademin dhe më pas me sëpatë në kokë",- thanë banorët.

BABAI I VIKTIMËS

Vrasja makabre e 37-vjeçarit ka tronditur famil-



Sëpata me të cilën u masakrua 37-vjeçari

jarët e tij, por edhe banorët e fshatit Gumenicë të Vlorës. Babai i viktimës tha se djali i tij, Ademi, në momentin e konfliktit ka qenë i shoqëruar nga i biri i tij 7 vjeç. "Djali ishte duke shkuar për në fermën e tij të dhive, kur është qëlluar me armë nga larg dhe

më pas autori, Dilaveri ka shkuar afër dhe e ka goditur në kokë me sëpatë. Nuk kemi pasur konflikte. Djali po shkonte me dhi, kur ndodhi ngjarja. Policia erdhi shpejt në vendngjarje dhe kapë autorin",-pohoi babai i 37-vjeçarit të vrarë.

Era e fortë rrëzon vetratën e xhamit, humb jetën kalimtari 67-vjeçar



VLORE - Era e fortë i ka marrë jetën një të moshuari në Vlorë. Një vetratë xhami është shpërndarë nga një pallat dhe i ka rënë në kokë kalimtari 67-vjeçar Ramadan Kaci. Ngjarja ndodhi dje rreth orës 12:50 në lagjen "28 Nëntori", në afërsi të Kishës Ortodokse në Vlorë. Mësohet, pak minuta pasi u transportua në spital, i moshuari ndërroi jetë. Ndërkaq,

policia u bëri thirrje të gjithë banorëve që të jenë shumë të kujdesshëm gjatë lëvizjes së tyre në këmbë, biçikletë apo automjete, si dhe të evitojnë lëvizjet e tyre të panevojshme deri në qetësimin e situatës meteorologjike. Gjithashtu, luten që për çdo nevojë apo problem që do të kenë të telefonojnë menjëherë në numrat pa pagesë 112 dhe 129.



Përmblyet, zona e Nënshkodrës ende nën ujë

SHKODËR - Zona e Nënshkodrës vazhdon të jetë e mbuluar nga uji. Prej disa ditësh forcat e ushtrisë qëndrojnë në gatishmëri për të përballuar çdo emergjencë të mundshme edhe pse fatmirësisht ka pasur vetëm një rast të tillë. Me dhjetëra shtëpi ndërkohë janë të rrethuara nga uji. Situata ndryshon me orë, por prej 3 ditësh sipërfaqja nën ujë është e njëjtë, 2400 hektarë. Në zonat e përmblytura të Nënshkodrës nuk mund të flasësh për një jetë të qetë, pasi frika bashkëjeton me këto familje. Uji u ka shkuar deri në pragun e shtëpisë, e rrezikon të hyjë brenda tyre. Në Obot ushtria ka mundur të hyjë para-dreken e së shtunës me mjete të larta, por niveli i ujit në rrugë shkon afro 1 metër. Varkat mund të rikthehen në përdorim për transportimin e banorëve dhe ushqimeve. Komandant i Batalionit Vau Dejes, Ali Mali, tha dje se të paktën edhe për 48 orët e ardhshme ushtria do të vijojë të qëndrojë me shërbim 24 orësh në këtë zonë, për t'iu ardhur në ndihmë banorëve. "Parashikohet një rritje e nivelit të ujit në krahasim me ditën e djeshme, deri në këto momente kemi lëvizur vetëm me moto-varka. Ndërsa në këtë moment sapo bëmë rrugën e parë dhe me mjetet e kalueshmërisë së lartë. Veç transportit të banorëve të nxënëseve të shkollës, njerëzve të sëmurë, banorëve të ndryshëm që lëvizin për punë dhe duhet të qarkullojnë nga fshati Obot për në Oblikë dhe Shkodër. Kemi transportuar dhe bazë ushqimore për blegtorinë",-pohoi Mali. Në Daç sipërfaqja e përmblytur është me e vogël, por 30 shtëpi në Shirë dhe Mushan janë të rrethuara nga uji. Banorët kanë shqetësim kryesor dëmshpërblimin dhe bazën ushqimore për gjënë e gjallë. Shkarkimet nga hidrocentrali i Vau Dejës vijojnë dhe sot niveli i tyre ka rënë në 600 metër/kub për sekondë. Rritje e nivelit të ujit vërehet në liqenin e Shkodrës dhe lumin Buna.

LEGALIZIMET LEJET

Ndërtuan pa leje, 43 personat që duhet të plotësojnë dokumentet për lejen

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 321 personat që kanë ndërtuar shtesa pa leje dhe kanë gati lejen e legalizimit. Përfutjesit duhet të paraqiten pranë drejtorisë së ALUIZNI-t "Tirana 2". Gjithashtu, pranë kësaj drejtorie duhet të paraqiten edhe 43 pronarë të tjerë që kanë ndërtuar shtesa pa leje, por që nuk kanë plotësuar ende dokumentacionin e nevojshëm për të marrë lejen e legalizimit.

TAPJA

Procedurat për marrjen e tapisë ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfutjesit duhet të shkojnë në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë pasi ajo

ALUIZNI, 321 pronarët që marrin tapitë për shtesat e shtëpive

Lejet e legalizimit në drejtorinë "Tirana 2"

të jetë gati. Pas ndryshimeve të fundit ligjore qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që

sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të

cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shitë poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin,

nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë

takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

LISTA E ALUIZNI-t

Për paraqitje pranë DREJTORISË SË ALUIZNI-t Tirana-2, për plotësimin e dokumentacionit për pajisje me Leje Legalizimi

NR. REND OR	EMER	ATESI	MBIEMER	NJESI ADMINISTRATIVE
1	Xheladin	Hasan	Zajmi	1
2	Besnik	Lutfi	Lloci	2
3	Eugen	Vangjel	Gace	2
4	Arben	Llambi	Simaku	2
5	Sokol	Bardhyl	Celibashi	2
6	Myzafer	Hamdi	Cela	2
7	Hyqmet	Hyqmet	Alibesi	2
8	Bledar	Ndue	Kacorri	3
9	Igli	Deme	Peci	3
10	Sokol	Xhelil	Hasani	4
11	Arben	Mehdi	Mitku	5
12	Edmond	Ramis	Selimaj	5
13	Astrit	Selim	Kapxhiu	5
14	Ermal	Bejkush	Bleta	5

Për paraqitje pranë DREJTORISË SË ALUIZNI-t Tirana-2, për plotësimin e dokumentacionit për pajisje me Leje Legalizimi

NR. REND OR	EMER	ATESI	MBIEMER	NJESI ADMINISTRATIVE
15	Gezim	Skender	Gjata	5
16	Riza	Avni	Cekrezi	5
17	Arta	Veli	Baraktari	5
18	Altin	Eqerem	Kalanxhi	5
19	Hamdi	Riza	Kazazi	5
20	Astrit	Ibrahim	Kaloshi	5
21	Dituri	Mihallaq Musa	Todi Cobo, Cobo	5
22	Skender	Osman	Kaciçi	5
23	Luan	Xhevdet	Mingomataj	5
24	Avdil	Reshir	Hoxha	7
25	Floresha	Sulo	Dhembi	7
26	Shaban	Shyqeri	Dybeli	7
27	Qazim	Halim	Kasa	8
28	Auron	Myslim	Pashaj	8

Për paraqitje pranë DREJTORISË SË ALUIZNI-t Tirana-2, për plotësimin e dokumentacionit për pajisje me Leje Legalizimi

NR. REND OR	EMER	ATESI	MBIEMER	NJESI ADMINISTRATIVE
29	Munir	Tahir	Salkurti	9
30	Shpend	Osman	Leka	9
31	Alban	Zaim	Bici	9
32	Hasan	Samet	Shehu	9
33	Ilda	Fatmir	Zaloshnja	9
34	Fatime	Skender	Peqini	9
35	Valentina	Hamit	Shehu	9
36	Muadez	Brahim	Selimaj	9
37	Valbona	Taip	Osmani	9
38	Gentian	Hydajet	Kuci	9
39	Nexhat	Ismail	Kurtulla	10
40	Koco	Kristaq	Manco	10
41	Arben	Mehdi	Zaloshnja	10
42	Gjergji	Petraç	Bicollari	10
43	Gezim	Isa	Guce	10

Për paraqitje pranë DREJTORISË SË ALUIZNI-t Tirana-2, për tërheqjen e Lejes së Legalizimit

NR. REND OR	EMER	ATESI	MBIEMER	NJESI ADMINISTRATIVE
1	Velisha	Avni	Alicka	1
2	Dhimiter	Llambro	Dhimitri	1
3	Tomorr	Selaudin	Çili	1
4	Shpetim	Murat	Bejko	1
5	Selvi	Mystehak	Cenaj	1
6	Asllan	Tajar	Sulaj	1
7	Velisha	Avni	Alicka	1
8	Isa	Sali	Benja	1
9	Qemal	Hysen	Denisi	1
10	Fatmir	Besim	Huta	1
11	Shazimane	Hasan	Fili	1
12	Artur	Myherdar	Hasantari	1
13	Petrit	Rakip	Haxhiaj	1
14	Isa	Sali	Benja	1
15	Qemal	Hysen	Denisi	1
16	MUSTAFA	SADIK	XHEPA	2
17	ILIR	PETRIT	SHIJAKU	2
18	ILIA	KRISTO	XHAXHE	2
19	MYSLYM	DINE	TERKUCI	2
20	NASI	LONI	GJERGO	2
21	ALI	NASIP	FRAKULLI	2
22	EDMOND	MUHAREM	KAMBERI	2
23	ARTUR	KASEM	SERJANAJ	2
24	ALBANO	ZIHNI	SINANI	2

Për paraqitje pranë DREJTORISË SË ALUIZNI-t Tirana-2, për tërheqjen e Lejes së Legalizimit

NR. REND OR	EMER	ATESI	MBIEMER	NJESI ADMINISTRATIVE
25	BAHRI	HAJDAR	KASTRATI	2
26	HYSEN	XHEVIT	ALLARAJ	2
27	OLTA	FATOS	PEMA	2
28	MYRSET	SERVET	XAMA	2
29	DHIMITER	KOCO	GJOKA	2
30	MUHAMET	YMER	YMERI	2
31	FATMIRE	DEMIR	LOKA	2
32	SULEJMAN	BABE	LAZE	2
33	SURE	HASAN	TAFJA	2
34	DRITAN	NIMAN	IDRIZI	2
35	VIKTOR	TAQO	QILLO	2
36	GEZIM	IBRAHIM	MALIQI	2
37	MUHAMET	IMER	HOXHAI	2
38	DRITAN	MAGNESON	BUNGO	2
39	NATASHA	HALIT	KOLECI	2
40	AFRIM	TOMORR	AGIM-GOSTIVARI	2
41	MEHMET PELLUMB, SONILA	XHEMIL	SONILA	2
42	SKENDER XHELAL	CASLLI		2
43	PELLUMB	SINAN	META	2
44	DONIKA	LIPI, ADIF	HOXHA	2
45	THEODHORI	JORGJI	PRIFTI	2
46	GEZIM	HYSNI	PETRELA	2
47	DONIKA	ILIAZ	SHEHU	2
48	LIMA + TRASHIGIMTARET	SHEME	HYSKO	2

Për paraqitje pranë DREJTORISË SË ALUIZNI-t Tirana-2, për tërheqjen e Lejes së Legalizimit

NR. REND OR	EMER	ATESI	MBIEMER	NJESI ADMINISTRATIVE
49	ASTRIT	HALIL	HYKA	2
50	LUAN	LAZE	ALIKO	2
51	JAKUP	SABRI	TAFJA	2
52	ARTAN	REFIK	SELIMAJ	2
53	DASHURI	ZYFER	TOSKA	2
54	PJERIN	TONIN	KRAJA	2
55	DALLANDYSHE		HEKURAN RUCI	
2				
56	EDI	SHENDI	PEPO	2
57	DHURATA	NEXHIP	BUDINI	2
58	HARILLAQ	SIKO	REBI	2
59	NAZMI	XHELAL	HASA	2
60	FLORIAN	MUHAMED	XHELEPI	2
61	ALKET	MUHAMED	XHELEPI	2
62	KRISTAQ	PLLATON	PULLA	2
63	GANI	IBRAHIM	SHEHI	2
64	DOLOR	JORGJI	SPIRU	2
65	MUHARREM, ZENEL	PLLOCI		2
66	FEHMI	FAIZ	LLESHI	2
67	ILIRJAN	PETRO	THAKA	2
68	FERDERIKA	FOTO	LAMANI	2
69	ALBERT	UMER	STRATI	2
70	EMILIA	HANS	BONATI	2
71	KRENAR	MURAT	SHEHAJ	2

72	KRISTO	FANE	THANATI	2	156	Iilir	Nazmi	Kumbaro	5	240	Agur	Selfo	Baxhia	7
73	HANIFE	SAFET	PERONA	2	157	Kristina	Harrilla	Hoxhaj	5	241	Dashnor	Teki	Diko	7
74	ARTUR		PORTUZI	2	158	Elisabeta	Xhelal	Dosti	5	242	Nafije	Isuf	Kau	7
75	AGRON	SEFER	DALIPAJ	2	159	Eleni	Apostol	Prokopi	5	243	Ledion	adrian	Nako	7
76	ALI	LAVER	CELANJI	2	160	Eral	Gafur	Como	5	244	Besim	Xhafer	Vrioni	7
77	Iilir	Rustem	Myteveli	3	161	Enik	Masar	Shehu	5	245	Veli		Dervishi	7
78	Reshat	Rait	Mullahaj	3	162	Teodor	Pandi	Todhe	5	246	Avdulla	Remzi	Avdullai	7
79	Valentina	Xhuvi	Shkoza	3	163	Hysen	Qerim	Verrija	5	247	Enver	Daut	Sheta	7
80	Suzana	Sitki	Ramku	3	164	Sulejman	Mustafa	Alla	5	248	Milika	Zilfo	Demaj	7
81	Beglije	Ramadan	Kadriu	3	165	Shpetim	Mehmet	Ferhati	5	249	Luan	sefedin	driza	7
82	Bexhet	Qamil	Cadri	3	166	Petrit	Jonuz	Dervishi	5	250	Dervish	Qerim	Saraci	7
83	Astrit	Nezir	Gjerani	3	167	Eriketa	Maksim	Bakiri	5	251	Fiqiri	Xhemal	Shehi	7
84	Zoica	Koli	Daka	3	168	Bujar	Isuf	Kurti	5	252	Zydi	Haki	Stermasi	7
85	Skender	Bexhet	SuTa	3	169	Tana	Tomor	Asllani	5	253	Sokol	Saxhit	Hasanllari	7
86	Agim	Sali	Bodlli	3	170	Artan	Vizhdan	Murrarj	5	254	Edmond	Ali	Memishaj	7
87	Adlije	Sait	Kalliri	3	171	Qemal	Isa	Isaraj	5	255	Gezim	Hasan	Fifo	7
88	Shuan	Shefqet	Rakipi	3	172	Armir	Ibrahim	Balili	5	256	Emrush	Ramiz	Reci	7
89	Besnik	Gani	Shahini	3	173	Hidai	Estref	Pulaj	5	257	Ferdane	Isa	Ademaj	7
90	Avni	Myrto	Hysa	3	174	Pellumb	Nuri	Zaimi	5	258	Lavdije	Luto	Dhima	7
91	Gezim	Xhoxhi	Gjata	3	175	Spiro	Sotir	Sterjo	5	259	Halil	Halil	Halil	8
92	Vasil		Kristo	3	176	Kodhel	Taip	Ismailaj	5	260	Fadil	Sefer	Nazja	8
93	Festim		Rexhepi	3	177	Merita	Halit	Gjiriti	5	261	Astrit	Dalip	Sulozeqaj	8
94	Selim	Muhamet	Hoxha	3	178	Luan	Bejko	Matohtiti	5	262	Arsine	Majko	Qirjako	8
95	Faik	Hetem	Alushllani	3	179	Elvira	Kristo	Mushi	5	263	Flutur	kadri	gorjani	8
96	Engjellushë	Ferat	Balla	3	180	Luigjana		Jano	5	264	Rushit	Yzeir	Leka	8
97	Faslli	Feta	Rizaj	3	181	Fatmir	Sulejman	Karapici	5	265	Gani	Zaim	Zajmi	8
98	Veronika	Spiro	Nine	3	182	Burhan	Ahmet	Lekaj	5	266	Hasan	Myftar	Hasaj	8
99	Ismail	Selman	Spahiu	3	183	Albert	Lutfi	Shehu	5	267	Ylli	Ali	Progri	8
100	Arben	Halit	Kapoli	3	184	Ismet		Luzati	5	268	Thanas	Marko	Kulo	8
101	Kastriot	Laman	Llapi	3	185	Skender	Hysen	Prela	5	269	Hajredin	Aziz	Mehmeti	8
102	Bashkim	Gafur	Lalaj	3	186	Gramoz		Shyti	5	270	Gjyle	Liman	Hoxhaj	8
103	Leonard	Petrit	Dema	3	187	Bashkim	Beqir	Mborja	5	271	Zef	Ndue	Tuci	8
104	Agim	Ymer	Zerka	3	188	Bimi	Beqir	Mborja	5	272	Fatmire	Shaban	Tresa	8
105	Xhemal	Kamber	Shehu	3	189	Saimir	Engjell	Gazheli	5	273	Albano	Mitat	Masha	8
106	Bashkim	Nike	Bakiasi	3	190	Llambi	Nikoll	Rula	5	274	Astrit	Sadik	Rama	9
107	Mane	Hiso	Hoxhaj	3	191	Agron	Thoma	Bufi	5	275	Bujar	Asllan	Shahini	9
108	Ilia	Koco	Dhrami	3	192	Gani	Brahim	Brahushaj	5	276	Mark	Ndue	Luli	9
109	Lulezim	Faik	Rakipi	4	193	Iilir	Hamdi	Lesha	5	277	Murat	Asim	Kalaja	9
110	Feruze	Zalo	Sula	4	194	Sokol	Ziver	Meko	5	278	Asim	Murat	Kalaja	9
111	Kujtim	Veiz	Kurti	4	195	Fatos	Shemko	Celo	5	279	Qefserë	Mitat	Kalaja	9
112	Agustin	Haki	Hysko	4	196	Ferit		Shijaku	5	280	Qemal	Murat	Kalaja	9
113	Mynaver	Nebi	Haxhiu	4	197	Arqile	Rako	Llupo	5	281	Lutfi	Vesel	Gorenxa	9
114	Njazi	Selim	Beqo	4	198	Agron	Mina	Vito	5	282	Artan	Ristan	Mitro	9
115	Artan	Gezim	Hasani	4	199	Bujar	Abaz	Kapllani	5	283	Dashamir	Muharrem	Koci	9
116	Muharrem,	Brahim	Lluga	4	200	Marash	Nuik	Cenaj	5	284	Pranvera	Fiqiri	Celi	9
117	Ivzi	Mahmut	Ibrahimi	4	201	Astrit	Maliq	Myftari	5	285	Gezim	Uran	Dino	9
118	Altin	Lipe	Priiftaj	4	202	Dhimiter	Andon	Thano	5	286	Mark	Nik	Grapcaj	9
119	Reshide	Hasan	Kalia	4	203	Andon	Gligor	Thano	5	287	Anila	Kasem	Merollari	9
120	Maliq	Haki	Istrefi	4	204	Gezim	Sedat	Kotoni	5	288	Gentian	Pjeter	Strati	9
121	Rasim	Bajram	Dervishi	4	205	Gjergji	Dhionis	Tite	5	289	Majllinda	Ylvi	Toro	9
122	Syrja		Lleshi	4	206	Zuhdi	Shyqeri	Nallbani	5	290	Vaide	Rexhep	Kojnara	9
123	Bajram	Xhemal	Xhemali	4	207	Kostaq	Ligor	Pashko	5	291	Fiqirete	Hysni	Beleshka	9
124	Fatmir	Aqif	Disha	4	208	Zef	Ndoc	Shala	5	292	Hysni	Hysen	Shehi	9
125	Agron	Muharrem	Jonuzi	4	209	Rajmond	Enver	Xherahu	5	293	Blerim	Naim	Çela	9
126	Myzafer		Sojli	4	210	Rexhep	Xhemal	Kacurri	5	294	Rifat	Sejdi	Gjoni	9
127	Fehmi	Rexhep	Shehu	4	211	Hikmet	Bexhet	Hoxha	5	295	Hamdi	Dervish	Mahila	9
128	Skender	Dilaver	Shahinaj	4	212	Kate	Braho	Dhrami	5	296	Sazan, Aurora		Velaj	9
129	Shkelqim	Mehmet	Mehja	4	213	Petrit	Guri	Selmanaj	5	297	Hiqmet	Shaban	Kellezi	9
130	Isak	Zenel	Lusha	4	214	Baki	Liman	Dedja	5	298	Mara	Qendro	Andoni	10
131	Xhabir	Tahir	Sula	4	215	Xhorxhi	Aziz	Elezri	5	299	Mrik	Fran	Nacaj	10
132	Mandarina	Syrja	Spahiu	4	216	Milo	Jani	Gjiknuri	5	300	Drin	Mufid	Gorica	10
133	Ymer	Qazim	Aliu	4	217	Arben	Sali	Gjoni	5	301	Rajmond	Anton	Perolla	10
134	Luan	Bajram	Licaj	4	218	Anila	Ahmet	Vorpsti	5	302	Thanas	Vllashi	Papa	10
135	Fitim	Shyqeri	Katrube	4	219	Pranvera	Hysen	Fida	5	303	Shpresa	Ismail	Papa	10
136	Ferit	Zyber	Brazhda	4	220	Mimoza	Kadri	Rusta	5	304	Lefter	Rako	Kole	10
137	Agil	Xhemal	Melani	4	221	Pandeli	Vaso	Marto	5	305	Sali		Osmani	10
138	Riza	Idriz	Shiqerukaj	4	222	Fatos	Dervish	Zere	5	306	Ali	Alush	Plaku	10
139	Ylber	Abduraman	Gjura	4	223	Kristaq	Gori	Papa	5	307	Luan	Muharrem	Ballabani	10
140	Qetsor	Rahip	Orhan	4	224	Mina	Kola	Nasto	5	308	Lutfi	Xhevit	Mbrati	10
141	Agron	Fari	Muço	4	225	Lirim		Zene	5	309	Diena	Ajet	Karanxhaj	10
142	Besnik	Gezim	Tahiri	4	226	Eldishane	Tefik	Velçani	5	310	Esiela	Dorian	Karanxhaj	10
143	Perparim	Mane	Xhelili	5	227	Vladimir ,	Arben Beqir	Kongjinaj	5	311	Lefter	Ismail	Hoxha	10
144	Eli	Nasi	Kristo	5	228	Shezai	Jonuz	Sinanaj	5	312	Artur	Tomor	Trenova	10
145	Nevruz	Veizir	Mersuli	5	229	Aluizni - Jorgo	Ndoni	Prifti	5	313	Dilaver	Haxhi	Karaj	10
146	Selim	Sali	Llani	5	230	Faslli	Njali	Korita	5	314	Selim	Sali	Llani	11
147	Dhimitri	Vadhi	Llazari	5	231	Antigoni	Nasho	Pata	5	315	Selim	Sali	Llani	11
148	Bahri	Sheme	Hazizaj	5	232	Namik	Xhemal	Çuçka	5	316	Muharrem	Banush	Bana	11
149	Rudi	Andrea	Ikonomi	5	233	Armel	shezai	Veshaj	6	317	Liri	Hamit	Lila	11
150	Rudi	Andrea	Ikonomi	5	234	Ferhat	Vait	Malaj	6	318	Gezim		Merdari	11
151	Gentian	Lutfi	Hoxhaj	5	235	Bilbil	Hamza Merko	hasanaj	6	319	Bardhyl	Hysen	Abazi	11
152	Pashuk	Ylli	Masmalaj	5	236	Skender	Hetem	Jaupaj	6	320	Pellumb		Berzani	11
153	Vladimir	Sulejman	Zajmi	5	237	Gjergj	Dhimitraq	Kovaci	7	321	Agim	Isa	Çela	11
154	Mehmet	Hasan	Bela	5	238	Perparim	Qemal	Shelej	7					
155	Xhevdet	Sherif	Haxhij	5	239	Anesti	Stefanaq	Foto	7					

NISMA

“NGA AUSTRIA ME DASHURI”

Kartolinat letrare si format komunikimi mes kulturave

Fatmira Nikolli

Kartolina letrare që nën titullin “Nga Austria me dashuri”, nuk do të shërbejë vetëm si komunikim përmes imazheve, siç është bërë tashmë një rutinë sot. Këtë ide ka propozuar “Poeteka” në përrurim të vitit kulturor mes Austrisë dhe Shqipërisë, mbështetur nga ambasada e austriake në Tiranë dhe partnerët e saj.

Nuk do të jetë thjesht një ngjarje e veçuar kulturore, por një sërë veprimtarish që, duke filluar nga 20 marsi, do të shtrihet përgjatë gjithë vitit 2018, duke hedhur çdo muaj në qarkullim një kartolinë dhe duke e ofruar atë në mjedisë publike të Tiranës dhe Shkodrës. Veprimtaria i drejtohet publikut të gjerë, nxënësve dhe studentëve, por veçanërisht lexuesve dhe përkthyesve, të cilëve u dhurohet një mjet të ri komunikimi, siç është komunikimi përmes kartolinave dhe të reja që përcjellin ato.

Nuk bëhet fjalë për mesazhe të shkurtër, por tekste të plota letrare si dhe për portretet e autorëve që i krijuan ato. Por mënyra e përdorimit të kartolinave letrare “Nga Austria me dashuri”, nuk kufizohet vetëm me leximin apo koleksionimin e tyre.

Ato fare mirë mund t’u dërgohen njerëzve të dashur në formën e kartolinave me mbishkrim, me shënime veti, por edhe si një mënyrë që nxit dhurimin e poezive për ngjarje të veçanta të jetës së gjithsecilit, kulturë kjo mjaft e përhapur në Europë. Të kjo prirje mund të shohim edhe një element alternativ që promovon shkrimin dhe leximin jashtë mjeteve të botës virtuale, që nxit dorëshkrimin dhe leximet në mjedisë intime dhe të hapura.

Kjo nisim që përurohet të dy kulturat, vjen në kuadrin e veprimtarive që zhvillohen nën moton “2018 - një vit plot ngjarje kulturore mes Austrisë dhe Shqipërisë”, që ambasada e Austrisë në Tiranë organizon në bashkëpunim me “POETEKA”, si pjesë e programit Poetry Card - From Austria to Albania with Love.

U zgjodh pikërisht formati i kartolinave letrare dhe jo ndonjë format tjetër komunikimi, pasi Austria njihet në Europë si një prej atyre vendeve që i përdorin që herët kartolinat si mjet komunikimi mes kulturave. Kjo prirje e tyre nuk u ndërpre madje as në vite të vështrë, si vites mes dy luftërave.



Viti i përbashkët kulturor nis me Rainer Maria Rilke

Tashmë ky komunikim përmes imazhit dhe tekstit që ofron kartolina, përbën një traditë të gjerë dhe të pasur prej 115-vjeçare në atë hapësirë.

POETEKA e rikthen këtë traditë përballë publikut shqiptar në një format të ri, kushtuar promovimit të kulturave përmes teksteve letrare, përmes përkthimit dhe leximit të autorëve austriakë dhe shqiptarë. Si pjesë e këtij programi “POETEKA” ka përgatitur një seri me kartolina kushtuar autorëve austriakë, krijimtarisë së tyre të përkthyer në shqip, por edhe disa autorëve shqiptarë që jetojnë në Austri.

Disa prej emrave të autorëve që përurohen përmes kartolinave letrare janë të

njohur, pasi një pjesë të krijimtarisë e kanë të lidhur me Shqipërinë dhe shqiptarët. I tillë është rasti i shkrimtarit austriak Joseph Roth, reportazhet e të cilit u botuan për herë të parë në vitin 1927 në faqet e gazetës gjermane “Frankfurter Zeitung” dhe që në shqip është përkthyer nga Lindita Arapi.

Por mes tyre do të ketë edhe autorë të tjerë, klasikë dhe bashkëkohorë, duke filluar me Rilke, të Jelinek, me Mira Lobe, të Klemens Reinoldner, nga autorja për fëmijë Christine Nöstlinger apo edhe autorë që e kanë vizituar Tiranën më herët përmes rezidencës letrare “POETEKA”, si artistë grafik dhe botuesi Christian Tanhäuser apo Ilir Ferrar.

Veçanti do të përbëjë edhe

Të gjithë së bashku, autorë, përkthyes dhe lexues komunikojnë mes tyre me ndërmjetësinë e kartolinave, imazheve të ballinave të librave dhe portreteve të autorëve dhe përkthyesve.

Përmes formatit të “fjalës fluturake”, rivendoset një marrëdhënie e veçantë jo vetëm me imazhin, por edhe me leximin. Ata që do i marrin në dorë kartolinat letrare, do të njihenjo thjesht me portretet e autorëve, por mund ta lexojnë krijimtarinë e tyre të përkthyer në gjuhën shqipe, ndërkohë që ata që njohin gjermanishten mund ta lexojnë këtë krijimtarinë në gjuhën origjinale të shkrimit. Por përmes kartolinave letrare u kushtohet vëmendje e posaçme edhe përkthyesve, si urë mjaft e rëndësishme komunikimi.

Nisma e promovimit të kulturave përmes projektit “Poetry-Card” - kartolina letrare, e çon datën e komunikimit letrar mes Austrisë dhe Shqipërisë jo vetëm në marrëdhëniet e sotme, por vendos si kufi të kësaj nisim një datë historike prej më shumë se 70 vjet.

Vetë programi, i shtrirë përgjatë gjithë vitit 2018, përmban mjaft befasi. Por takimi përurohet i formatit të kartolinave letrare, që mbahet në “Hemingway”, ditën e martë, më 20 Mars, në vigjilje të Ditës Botërore

fakti që disa nga kartolinat letrare do të përurohen gjatë kohës kur autorët të gjenden në Shqipëri, siç është rasti i shkrimtarës dhe përkthyeses Andrea Grill apo i shkrimtarit Karl Markus Gauß, që do të jetë në Tiranë gjatë muajit tetor 2018.

Në këtë revistë letrare, pavarësisht nga vitet e vështira politike, janë promovuar vlera të kulturës letrare austriake. Bashkë me to, kureshtja e këtij përurore shtohet përmes përkthimit në shqip të një poezie të Rilkes, nënshkruar me pseudonim letrar nga një autor e përkthyes i njohur më pas, që asokohe ishte në hapat e tij të parë të krijimtarisë.

Për një komunikim më të gjerë me publikun programi “Poetry Card - From Austria to Albania with love” do të bëhet i njohur përmes takimeve dhe bisedave në shkollë, në qoshkat letrare dhe kafe-libraritë e kryeqytetit dhe të disa qyteteve të tjerë, në institucione të ndryshme kulturore, në galeri arti, autobusë turistike, të cilat do e mbështillin qytetin me këtë atmosferë të rrallë të komunikimit përmes kulturave.

Gratë diplomate që njohën Nënë Terezën, rrëfihen në një libër

Sapo doli nga shtyp libri “Il giorno di Santa Madre Teresa” (“Dita e Shenjtores Nënë Tereza”), botim i shtëpisë botuese të Vatikani LEV (Libreria Editrice Vaticana), më prestigjioza e ndër më të njohurat në Itali. Autore e tij është Edlira Zhiti, që ideoi dhe mboldhi emociot dhe mbresat e grave ambasadore dhe bashkëshorteve të ambasadorëve pranë Selisë së Shenjtë, të pranishëm në ditën e Shenjtëritimit të Nënë Terezës në Sheshin “San Pietro” në meshën e madhe të celebruar nga Papa Françesku. Edlira Zhiti me ato shkrime krijoi antologjinë e saj, të veçantë, origjinale e uni-

versale. Secila prej pjesëmarrësve në antologji, ambasadore apo bashkëshorte ambasadori, ka sjellë rrëfime e përjetatje të drejtpërdrejta, që i lidhin me Shenjtoeren. Disa prej tyre kanë pasur fatin jo vetëm ta takojnë, por dhe të luten së bashku me të, dikush tjetër tregon një udhëtim nga Roma në Vjenë, pas lumturimit të Nënë Terezës - me reliktet e saj, një tjetër tregon dhe për takimin e Nënë Terezës në Tiranë me vejushën e diktatorit, një grua tjetër, tregon që e arrestojnë në moshën 18-vjeçare se shpërndante literaturë subversive, ndërsa më vonë një



Kopertina e librit net me lutjet e Nënë Terezës duke fituar kështu lirinë e brendshme. Veç këtyre ka edhe mjaft dëshmi të tjera. “Fryma e Nënë Terezës na ka

bashkuar të gjithëve”, - shkruan Edlira Zhiti në esenë e saj që paraprin shkrimet, ku gjenden ato të ambasadorëve, asaj të Mbretërisë së Bashkuar, të Bosnjës, të Gjeorgjisë, të San Marinos, të bashkëshorteve të ambasadorëve të Japonisë, ndërkohë dhe konsulente e botimit, e Angolës, Austrisë, Kanadasë, Kilit, Guatemalës, Indonezisë, Italisë, Libanit, Polonisë, Republikës Demokratike të Kongsos, Rusisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Hungarisë e Bashkimit Europian. Në fund të librit janë vendosur dëshmitë e dy murgeshave shqiptare,

Motër Elena e Motër Majlinda, të cilat të frymëzuara prej Nënë Terezës kanë ndjekur rrugën e saj. “E kam ndjekur Nënë Terezën”, - thotë Edlira Zhiti. “Kam qenë në ditën e Lumturimit të Saj si pelerinë në Sheshin ‘Shën Pjetër’ së bashku me bashkëshortin dhe djalin tonë, Atjotin.

Në ditën e shenjtëritimit të Nënë Terezës ku merrja pjesë si bashkëshorte e titullarit të ambasadës shqiptare, sytë e mi nguleshin të vendi ku Atjoni ishte ulur dikur. Prania e tij e përhershme me ne, që drejtum zëmërnë dhe hapat e mi, më thërriste ta bëja këtë libër, që përbashkon shtete e kontinente me bukurinë e pafund të shpirtit të gruas, të shenjtërisë së nënës”.

**E DIEL
18 Mars
2018**



Nga Ben Andoni

Nëse projekti për ngritjen e xhamisë së madhe të Tiranës do të ishte më transparent dhe do hartohesh disi më ngadalë, duke përfshirë këtu edhe mendimin e grupeve të interesit, me shumë gjasë do të kishim një objekt me një fizionomi tjetër fetare. Por, ndodhi. Projekti i nisur tre vjet më parë për ndërtimin e Xhamisë së Namasgjatë në Tiranë duhet që të mbarojë këtë vit. Ndërtimi ka hedhur shtat menjëherë dhe tashmë priten vetëm punimet më të vogla për t'i dhënë fund ngrehinës që me shumë gjasë do ta inaugurojë vetë presidenti i Turqisë Erdogan.

Ka pasur një mirëkuptim por edhe një dëshirë mes besimtarësh të kultivuar për një objekt prestigjioz, që ta mblidhte komunitetin e madh mysliman në Tiranë nën një ngrehinë që përfaqëson-te masën e tyre por edhe cilësinë arkitekturore, që përfaqëson sot Islami. Dhe, realisht, Islami nëpër botë, është munduar të imponohet me arkitekturën moderne që ka shpallur por edhe kërkesat tejet të larta. Pse nuk ndodhi një gjë e tillë në Shqipëri me një godinë kaq të stilit të vjetër? Pak kush mund të japë përgjigje për të. Kurse projekti që u nis nuk përfundoi. Debatit që ekzistoi me objektin e parë ideuar të bëhej në veri të Operas, nuk u konkludua për efekt të problemeve të pronësisë.



Duket se për xhaminë aktuale vendosën palët e vendimit. Komuniteti Mysliman shqiptar, në letargjinë e vet thjesht ndoqi palët, kurse komuniteti i arkitektëve vendas as u mor parasysh. Ashtu si në raste të tjera, ky komunitet u mënjanua për të mos u dëgjuar në argumentet profesionale, që shkonin që në shqyrtimet e formës, vëndndodhjen por edhe ndoshta kapacitetin.

Xhamia, duke iu referuar mendimit të arkitektëve, është një kopje e xhamisë së Sulltan Ahmetit (Referuar si Xhamia Blu) në Stamboll, ngrehinë e cila identifikohet si objekt me një "stil mirëfilli mesjetar turko-osman". Është një xhami tipike imperiale, falë katër minareve impozante, që zakonisht ndërtoheshin për vendet ku ishin prezente triumfet ormane.

Xhamia duhet t'i shkojë shtatit të një vendi, që kërkon veç të tjerash përmes stilit dhe paraqitjes së vet, projeksonin e Islamit në shekullin ku jetojmë. Në një farë mënyre çdo objekt jep cilësitë e kohës, por edhe sfidën e arkitektëve ndaj saj. Nuk ndodh një gjë e tillë në vendin tonë, kurse për këtë objekt nuk mund të thuhet kurrsesi se i shkon kohës ku jetojmë dhe arrin të paraqesë fizionominë dhe karakteristikat e Islamit të sotëm.



Vijon në faqen 15



Sikur të ndërtonim një Xhami moderne!



**Në këtë numër: TEATRI I RI KOMBËTAR, REALITETI I TË ARDHMES DO NXJERRË TË VËRTETËN TEATRI NË EPOKËN E SHEKSPIRIT, SHFAQJET NË "GLOBUS"- M.MOROZOV
LE CLEZIO: "NDOSHTA ROLI I LETËRSISË SOT ËSHTË T'I BËJË JEHONË KAOSIT" (INTERVISTA)
ANTROPOLOGJIA-AKTIVIZMI KULTUROR-PROF. ALBERT DOJA*
WISLAWA SZYMBORSKA DHE ADAM ZAGAJEWSKI NËN PËRKTHIMIN E PANDELI ÇINËS
KRIJIMTARI-PA GËZIME-DEMIR GJERGJI**

A

ARGUMENT

NGA Prof. ALBERT DOJA*

Vijon nga numri i shkruar

Një çështje që haset rëndom në etnografinë ballkanike, sidomos në etnografinë shqiptare, është pikëpamja që lidh tiparet kulturore patriarkale me nivele të larta të lindshmërisë, me struktura komplekse të familjes së zgjeruar, me modele të ngurta martesore, apo me mitet dhe ideologjitë kulturore të nderit e të gjakut. Veçanërisht ndërtimi ideologjik i mitit të femijëve të shumtë brenda të ashtuquajturave struktura klanore të familjes shqiptare të supozuar patriarkale përcillet rëndom në shkrimet studimore apo në mediat dhe opinionet e stereotipizuara. Pa u ndalur këtu për të vënë në dyshim nëse sistemi familjar shqiptar është patriarkal apo jo, duket se mitet kulturore dhe ideologjitë e lidhura me marrëdhëniet patrilineare u vishen praktikave patriarkale. Shumë komentatorë supozojnë me shumë mendjelehtësi se gjuha dhe ligërimet patriarkale që mbështesin simbolikisht marrëdhëniet patrilineare rezultojnë në mënyrë të njëtrajtshme në pasojë dhe praktika që thjesht sendërtohen si patriarkale.

Në kundërshtim me pikëpamjet e deritanishme, një lexim më i kujdesshëm dhe një analizë kritike më sistematike e të dhënave demografike, burimeve historike dhe dëshmi etnografike tregon qartë se familja shqiptare është përbërur për një kohë të gjatë me nivele veçanërisht të ulëta të lindshmërisë dhe me një moshë mesatare relativisht të lartë në martesë për gratë. Një qasje më analitike e modelit organizativ segmentar të grupimeve agnatike paralele në shoqëritë e Europës Juglindore, duke përfshirë Shqipërinë, mund të zbulojë gjithashtu se struktura segmentare e organizimit shoqëror është e papërshtatshme për të mbështetur supozimin e një familjeje të zgjeruar patriarkale.

Gjithashtu, mbi bazën e një kuptimi më experiential të dëshmi etnografike, sjellja shoqërore në lidhje me përzgjedhjen e seksit në lindje, si dhe mënyrat e shprehjes së dhimbjes nga ana e grave gjatë lindjes, mund të jetë një tjetër tregues i tërthortë i agjencisë së grave për të rivendosur rolin e tyre në riprodhimin e brezave dhe për të kapërcyer kornizat tradicionale të ideologjisë patriarkale. Në të vërtetë, si gratë edhe burrat shqiptarë ka më shumë gjasa të preferojnë djem, por të dy ka gjasa të provojnë edhe për një vajzë, sidomos pas një djali, madje edhe mund të thonë ndonjëherë se preferojnë që femija e tyre të jetë vajzë. Kjo është e vërtetë pavarësisht nga preferencat e tyre të dukshme për djalë, pavarësisht nga mungesa relative e autonomisë së grave në vendim-marrjet riprodhuese, pavarësisht faktit që gratë tregojnë rrallë se sfidojnë vendimet e bashkëshort-

Në kundërshtim me pikëpamjet e deritanishme, një lexim më i kujdesshëm dhe një analizë kritike më sistematike e të dhënave demografike, burimeve historike dhe dëshmi etnografike tregon qartë se familja shqiptare është përbërur për një kohë të gjatë me nivele veçanërisht të ulëta të lindshmërisë dhe me një moshë mesatare relativisht të lartë në martesë për gratë. Një qasje më analitike e modelit organizativ segmentar të grupimeve agnatike paralele në shoqëritë e Europës Juglindore, duke përfshirë Shqipërinë, mund të zbulojë gjithashtu, se struktura segmentare e organizimit shoqëror është e papërshtatshme për të mbështetur supozimin e një familjeje të zgjeruar patriarkale.



Shpjegimet feministe

Shpjegimet feministe të përdhunimeve seksuale gjatë konflikteve etnike në ish Jugosllavi dhe vende të tjera kanë vënë gjerësisht në dukje rëndësinë e maskulinizmit misogjinist, duke përgatitur terrenin për një qasje ahistorike, e cila gjithashtu ka sendërtuar një konceptualizim të ashtuquajturave struktura, norma dhe vlera shoqërore ballkanike të prapambetura.



AKTIVIZMI KULTUROR

it të tyre, apo pavarësisht faktit që ato rrallë tregojnë se pajtohen me gjendjen e tyre në familje dhe në shoqëri.

Një qasje morfodinamike dhe analizë transformuese tregon se ndërtimi ideologjik i këtyre miteve, veçanërisht dëshmia e supozuar e femijëve të shumtë brenda të ashtuquajturave struktura klanore të familjes shqiptare të supozuar patriarkale mund të hidhet poshtë si një mit apo ideologji familjare. Një mënyrë për ta konceptuar këtë mit është nëpërmjet formalizimit kanonik, në të cilin funksioni empirik i femijëve të shumtë qëndron ndaj funksionit patriarkal të familjes së madhe ashtu si funksioni patriarkal i femijëve të shumtë qëndron ndaj funksionit të ideologjisë familjare për të krijuar një *dëshmi faktike*¹, që është një fakt i kthyer së prapthi, një fakt i paqenë apo anti-fakt.

femijë të shumtë^(dëshmi faktike): familje e madhe^(patriarkal) → femijë të shumtë^(patriarkal): dëshmi faktike¹ (familje e madhe)

Në këto kushte, gjithçka që në opinionet studimore dhe mediatike përcillet rëndom si dëshmi empirike nuk është veçse shprehje e një trysnie kulturore që nënshtron si gratë edhe burrat në riprodhimin e normave dhe vlerave shoqërore, duke synuar të kufizojë gratë shqiptare në funksionin e tyre të lindjes dhe burrat shqiptarë në funksionin e tyre të mbrojtjes. Kemi të bëjmë kështu me një aktivizëm të fortë kulturor, i cili vepron si një lloj i asaj që kam quajtur "Viagra kulturore" për mbijetesë shoqërore. Por më shumë se çdo gjë tjetër kjo na lejon të marrim parasysh kushtet strukturore, historike dhe politike në të cilat zhvillohet sjellja shoqërore. Përfundimisht, aktivizmi kulturor nuk shërben veçse për të anashkaluar dhe mbajtur të fshehur një fakt të rëndësishëm të një dimensionit të pastër ideologjik, që mund të zbulohet me anë të formalizimit kanonik të mbarë të dhënave brenda qasjes morfodinamike dhe analizës trans-

Strukturat familjare, lidhja me gjakun

Nëse shqyrtojmë nga afër strukturat familjare, vlerat shoqërore dhe praktikave kulturore, si martesë edhe hakmarrja mbështeten mbi simbolin e gjakut dhe të dyja janë institucione që u japin formë si aleancave edhe konflikteve. Nëse martesë ka krijuar një rrjet aleancash shoqërore dhe ka ndarë shoqërinë në grupe ekzogame, edhe hakmarrja ka krijuar një skenar vazhdimisht të lëvizshëm, ku anëtarësitë dhe aleancat strategjike mpiksin vazhdimisht qëndrueshmërinë e grupeve agnatike.

formuese. POLITIKA E PËRDHUNIMEVE SEKSUALE

Vitin e kaluar në prill 2016, në një Konferencë mbi luftën dhe dhunën seksuale të mbajtur në Qendrën e Studimeve Doktorale të Universitetit të Qytetit New York, kam paraqitur një rast tjetër shumë aktual dhe më shumë të qartë. Shpjegimet feministe të përdhunimeve seksuale gjatë konflikteve etnike në ish Jugosllavi dhe vende të tjera kanë vënë gjerësisht në dukje rëndësinë e maskulinizmit misogjinist, duke përgatitur terrenin për një qasje ahistorike, e cila gjithashtu ka sendërtuar një konceptu-

alizim të të ashtuquajturave struktura, norma dhe vlera shoqërore ballkanike të prapambetura. Një mënyrë e zakonshme për t'iu qasur dimensioneve të përdhunimit masiv dhe dhunës seksuale gjatë konflikteve etnike famëkeqe në ish Jugosllavi ka qenë t'i shpjegojë ato posaçërisht mbi bazën e një sfondi kulturor që mbështetet nga ekzistenca e një shoqërie fisnore, me struktura komplekse të përbashkëta familjare të njohura si zadruga në zonat sllavo-jugore, ligje zakonore të njohura si kanuni në zonën veriore shqiptare, praktika patriarkale apo zakone të tjera të egrish. Kjo nuk është vetëm e tur-

bullt, por edhe e paskrupullt.

Nëse shqyrtojmë nga afër strukturat familjare, vlerat shoqërore dhe praktikave kulturore, si martesë edhe hakmarrja mbështeten mbi simbolin e gjakut dhe të dyja janë institucione që u japin formë si aleancave edhe konflikteve. Nëse martesë ka krijuar një rrjet aleancash shoqërore dhe ka ndarë shoqërinë në grupe ekzogame, edhe hakmarrja ka krijuar një skenar vazhdimisht të lëvizshëm, ku anëtarësitë dhe aleancat strategjike mpiksin vazhdimisht qëndrueshmërinë e grupeve agnatike. Në përgjithësi, lidhja martesore apo mikpritja përjetohet si një marrëdhënie miqësie dhe solidariteti, ashtu si hakmarrja përjetohet si një marrëdhënie armiqësie dhe urrejtjeje. Por nëse lidhja martesore dhe hakmarrja i kundërvihen njëra-tjetrës si modalitete strukturore të asociimit apo disocimit mes grupeve të ndryshme agnatike, edhe miqësia dhe armiqësia janë pjesë e së njëjtës kundërvënie. Lidhja martesore dhe hakmarrja, miqësia dhe armiqësia ishin vetëm shprehje të ndryshme të një marrëdhënieje të vetme dhe unike strukturore.

Përfundimisht, të gjitha marrëdhëniet dhe vlerat shoqërore mbeten të vendosura nën shenjën e ambivalencës. Në këtë kuptim, në një nivel më empirik, ndjenjat emocionale si dhe marrëdhëniet shoqërore dhe vlerat e martesës, miqësisë dhe mikpritjes duhet të kenë diçka të përbashkët me marrëdhënien e dashurisë dhe solidaritetit ndaj urrejtjes dhe shpërbërjes shoqërore. Pikërisht kjo lloj ambivalence strukturore mund të lejojë një qasje të re teorike dhe metodologjike për të shpjeguar efektivitetin e përdhunimeve seksuale masive si një strategji ushtarake e spastrimit etnik në ish Jugosllavi.

Martesa është një transakcion i grave që shkëmbehen midis grupeve agnatike të burrave, një transakcion zakonor që synon të vulosë aleancat politike dhe të shlyejë borxhet e gjakut, nderit, apo parave. Në



Albert Doja


A
ARGUMENT

NGA BEN ANDONI

Vijon nga faqja 13

Xhamia, duke iu referuar mendimit të arkitektëve, është një kopje e xhamisë së Sulltan Ahmetit (Referuar si Xhamia Blu) në Stamboll, ngrehinë e cila identifikohet si objekt me një "stil mirëfilli mesjetar turko-osman". Është një xhami tipike imperiale, falë katër minareve imponante, që zakonisht ndërtoheshin për vendet ku ishin prezente triumfet ormane. Xhamia duhet t'i shkojë shtatit të një vendi, që kërkon veç të tjerash përmes stilit dhe paraqitjes së vet, projekcionin e Islamit në shekullin ku jetojmë. Në një farë mënyre çdo objekt jep cilësitë e kohës, por edhe sfidën e arkitektëve ndaj saj. Nuk ndodh një gjë e tillë në vendin tonë, kurse për këtë objekt nuk mund të thuhet kurrëse se i shkon kohës ku jetojmë dhe arrin të paraqesë fizionominë dhe karakteristikat e Islamit të sotëm. Ndërkohë nëse do të përfshi-

Sikur t'i dhuronim Tiranës një xhami moderne!



hej dhe komuniteti vendas, por qoftë dhe arkitektë të huaj, Shqipëria mund të kishte një xhami po kaq madhështore, jo me përfytyrime imperiale, por të këndshme, që e paraqiste si duhet ngrehinën mes zhvillimeve të reja moderne të Tiranës. Një shembull të bukur e paraqiti për publikum kohë më parë arkitekti Maks Velo. Një formë e jashtëzakonshme në formë eliptike, e ndarë në mes, ku pjesa e

sipërme do të shërbente për ritualin e faljes, shërbesat dhe të folmen e Imamit. Shoqëruar me një Minare, që po ashtu harkohej bukur krahas saj. Në një farë mënyre në mënyrë metaforike kishim Hënën e zbritur në Tokë, simbolin mysliman, porë në një perspektivë tejet interesante. Interieri do kishte një akustikë të mrekullueshme, që i jepte kuptim të gjithë ndërtimit, por edhe mënyrës së përhapjes së me-

sazhit të myslimanëve në ditët e sotme. Për fat të keq, projekti ose propozimi mediatik i arkitektit kaloi pa u vënë re dhe nuk është marrë parasysh sepse dukej që objekti i xhamisë së madhe ishte paravendosur. Maks Velo e ka paraqitur dhe e ka prezantuar dhe ishte shumë i dhënë që ndoshta edhe të përfshihej në ndonjë konkurs për të, por ndodhi që ajo ishte vendosur me kohë.

Themelet e xhamisë u hodhën më 13 maj 2015, në prani të Presidentit të Shqipërisë Bujar Nishanit dhe Presidentit të Turqisë Rexhep Taip Erdoanit. Xhamia mëtohet të përfundojë në vitin 2018. Ajo po realizohet me mbështetjen financiare nga fondacioni i Presidencës turke të Çështjeve Fetare dhe do ketë mbështetje edhe nga qeveria shqiptare.

Elementët teknikë janë shumë sfidues: Xhamia do të ketë katër minare me gjatësi 50 metër dhe një kupolë qendrore të stilit klasik turk, e gjatë 30 metra. E gjithë sipërfaqja e xhamisë do jetë rreth 10,000 m² kur kati i parë i xhamisë do të jetë i përbërë nga një qendër kulture, sallë konferencash, bibliotekë, sallë ekspozitash, restorante, dhoma pune dhe dhjetë klasa për studim e fesë islame dhe Kuranit. Në llogaritjet e arkitektëve besohet se do jenë rreth 4.500 besimtarë që do mund të falen njëkohësisht në xhami.

Xhami imponante por që realisht nuk i përshatet shumë karakteristikave të sotme të Islamit shqiptar.

këtë kuptim, martesat nuk është vetëm një institucion shoqëror i marrëdhënieve seksuale, por edhe një rregullim seksual i dhunës shoqërore dhe një institucion seksual i stabilitetit shoqëror. Gjithashtu, edhe përdhunimi si një marrëdhënie seksuale e detyruar nuk është një shprehje e thjeshtë agresive e seksualitetit, por një shprehje seksuale e dhunës shoqërore. Nga pozicioni i logjikës strukturore, martesat bëhet e mundur me anë të aleancës martesore që supozohet të sjellë dashuri, miqësi dhe solidaritet. Në të njëjtën mënyrë, përdhunimi mund të përkufizohet si një anti-aleancë kundërvënëse që bëhet e mundur nga mjetet e luftës dhe që synon domosdoshmërisht të shkaktojë urrejtje, armiqësi dhe shpërbërje shoqërore.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ngjarjet e përdhunimit dhe martesës duhen kuptuar në një marrëdhënie strukturore binare të ngurtë, sepse ka domosdoshmërisht një problem me këtë argument që frymëzohet nga logjika analogjike e Aristotelit, e cila në këtë rast nuk mund të jetë e vlefshme. Marrëdhënia permutacionale midis termave indekale dhe vlerave funksionale, si të përdhunimit dhe të martesës, mund të kartografohen në mënyrë produktive mbi bazën e një modeli katastrofik sipas teorisë morfodinamike të Lévi-Strauss. Në të vërtetë, jo vetëm lufta është një katastrofë, por përdhunimi seksual në luftë është një katastrofë më vete. Prandaj, mund të paraqitet një model katastrofik për të konceptuar përdhunimin me anë të një formalizim kanonik, në të cilin roli i solidaritetit të martesës do të qëndrojë ndaj armiqësisë së përdhunimit, ashtu si ambivalenca e martesës qëndron ndaj politikës së



përdhunimit të një solidaritetit, i papërshtatshëm dhe i paimagjueshëm, që është një solidaritet me kokë poshtë ose një kundër-solidaritet:

martese^(solidaritet) :
përdhunim^(armiqësi) :: martese^(armiqësi) :
solidaritet^(përdhunim)

Këtu përdhunimi zëvendësohet me dhunë nga martesat, e kundërta e vet, ndërsa një inversion korrelativ kryhet midis ambivalencës funksionale të martesës dhe ontologjisë së panjohur e të papërshtatshme të një funksioni përdhunues të detyruar. Megjithatë, për të kryer një operacion katastrofik të këtij lloji, kërkohet operimi logjik i një kushti kufizues. Një interesim kryesor i studimeve bashkëkohore antropologjike në lidhje me dhunën gjinore gjatë luftës, në ish-Jugosllavi apo në vende të tjera, është roli i ligjërimeve tradicionaliste dhe nacionaliste, që identifikohet këtu në mënyrë matematikore si një domosdoshmëri logjike nga kërkesa e një kushti kufizues për formalizimin kanonik. Në të vërtetë, në një kontekst ku përdhunimi në masë është

përdorur qëllimisht si një instrument i mundshëm i spastrimit etnik, gjithçka ka ndodhur sikur aktivizimi i një agjencie të veçantë politike dhe instrumentale të ishte i nevojshëm për të realizuar efektivititetin famëkeq të përdhunimit masiv. Kjo lloj agjencie ideologjike mund të tregohet se ka vënë në plan të parë dhe ka promovuar supozimet kulturore specifike të një grupi të caktuar. Gjatë luftës së Bosnjës dhe luftës së Kosovës në ish-Jugosllavi, kjo ka siguruar në radhë të parë që roli në rritje i ligjërimeve të qëllimshme të shpërthjeve rëndin moral dhe morfologjinë shoqërore, pikërisht duke nxjerrë në pah përdorimin shkatërrues të nderit të familjes dhe ideologjisë së gjakut. Në të vërtetë, përdhunimet masive të grave kanë patur për qëllim të futin me dhunë një lloj turpi dhe turpërimi si një ndotje shoqërore që duhet të sjellë domosdoshmërisht çrregullimin dhe shkatërrimin e sistemit shoqëror të çdo grupi në tërësinë e vet. Në mënyrë tipike, gjatë luftës, një ndotje e tillë shoqërore dhe çrregullim katastrofik quhet në shqip

shfarosje, i cili është një term gjenetik për asgjësim total, por që fjalë për fjalë do të thotë "çrrënjosje farefisnore".

Duke u kthyer në një terminologji të parafrazuar nga Lévi-Strauss në librin e tij mbi të Pagatuarat dhe të Pjekurat (1964), efektivititeti politik i papërshtatshëm i përdhunimeve masive paraqitet jo thjesht si një marrëzi e "pajjekur" e normave dhe vlerave kulturore, por është kryesisht përdredhja e një dëmi të keq të "gatuar" prej agjencisë ideologjike që ka vepruar si një politikë instrumentale e spastrimit etnik gjatë konflikteve etnike në ish Jugosllavi. Aktivizimi kulturor i nderit të familjes dhe ideologjisë së gjakut bën të mundur me pas që normat dhe vlerat familjare të konvertohen në ideologji etno-fetare, që përkatësia etnike të shndërrohet në vetëdije nacionaliste, që kjo vetëdije të organizohet në konflikt dhe që nacionalizmi i organizuar të bëhet militarist, maskulinist, racist, mizor dhe i dhunshëm.

POLITIKA IDENTITARE

Kërkesa e një kushti operativ që në studimin e miteve shprehët si një kusht kufizues në kuptim matematikor mund të jetë me interes të veçantë për studimin e transformimeve identitare, në analizën krahasuese të transformimeve që rezultojnë nga dinamika ndërkulturore, veçanërisht në proceset e ndërtimit identitar dhe të politikës identitare. Kjo më sjell në rastin e fundit, domethënë propozimin kërkimor mbi morfodinamikën e transformimeve identitare evropiane që kam ndërmend të zhvilloj gjatë qëndrimit tim në Harvard si studiues vizitues dhe që synon të fuqizojë konstruktivizimin neo-struktural duke kthyer vëmendjen drejt implikimeve thellësisht politike. Marrëdhëniet shoqërore janë

shpesh të çuditshme dhe kundërtënesë. Veçanërisht në fushën e identitetit, praktikatat ligjërimore nuk kanë gjithmonë veçori të përcaktuara ontologjike. Shpesh ato duket sikur janë të ngatërruara në kombinime të çuditshme gjendesh në dukje të papërshtatshme të karakteristikave të tyre shoqërore, që mund të jenë etnike-fetare dhe kombëtare-populiste apo qytetare dhe normative. Në këtë kuptim, ontologjia e identitetit mund të krahasohen me gjendjen në dukje misterioze të grimcave që në mekanikën kuantike quhet mbivendosje. Grupe fizikanësh nga Massachusetts Institute of Technology dhe disa universitete franceze po kryejnë prova në kushte reale për të parë nëse grimcat kuantike ekzistojnë vërtet në gjendje të mbivendosjes. Me duket se një lidhje e krahasueshme kuantike për t'u provuar mund të ekzistojë edhe në fushën identitare midis ideve, vlerave dhe motiveve në dukje të kundërta dhe të papërshtatshme. Supozimi kryesor është se transformimet identitare preken nga ideologji kulturore në dukje të kundërta, por që janë në marrëdhënie të ndërsjellë ndaj njëra-tjetrës duke vepruar si instrumente politike të pushtetit dhe hegjemonisë.

(vijon)

***Fjalë e dhënë në Universitetin Harvard, 20 shtator 2017. Përktheu nga anglishtja Enika Abazi. Marrë nga "Social Morphodynamics: Mapping Identity Transformations, Cultural Encounters, and the Evolution of Core Values." Social Epistemology Review and Reply Collective, vol. 7, no. 1 (2018), pp. 14-25. <https://wp.me/p1Bfg0-3Sz>**

I

INTERVISTË

Kjo është një intervistë e realizuar me nobelistin e vitit 2008-ës Jean Marie Gustav LE CLÉZIO. Në këtë intervistë autori shpjegon shumë elemente të letërsisë së tij.

NGA FRANCE DIPLOMATIE*

Në panoramën letrare franceze Jean Marie Gustav Le Clézio zë një vend të veçantë për sa i përket të grupeve, shkollave, modave. Francez dhe maurician njëherësh, i mësuar, i rritur me kulturën frënge dhe njohës i hollë i letërsisë anglo-saksone, ky romancier i jashtëzakonshëm mburret me Lotremonin, Zolain, por gjithashtu me Stivenonin dhe Xhojsin. Kritika gjithnjë ka hequr këq ta ngacmojë, ta kufizojë në ndonjë përcaktim të veçantë. Qysh atëherë, nga romani i tij i parë, Procesverbal (1963), që i dha çmimin e përmendur "Teofrast Renodo" qysh në moshën njëzetetrevjeçare, shkrimësia, ashtu si tematikat e tij kanë përparuar dhe ndryshuar mjaft. Vepra e tij, pa-



Meksiko, ishullit Mauricius, nga ku rrjedh dhe familja juaj dhe Nicës, ku jeni rritur dhe ku ende jeton nëna juaj. Ashtu si ju, personazhet e tregimeve tuaja janë të shkapërdarë mes kontinenteve. Për shembull, *Zemër e djegur* dhe romancat e tjera shtjellohen në Meksikë. Novela e parë e përmbledhjes rrëfen historinë e dy grave të reja, që kanë jetuar aty kur kanë qenë të vogla. Ajo ishte një fëmijëri traumatike. Ato dukeshin të gjitha të mendjeerësuar nga kjo e kaluar. A mund të thuhet se dy motrat janë viktimat të endacakërisë?

Le Clézio : Ato janë viktimat e të përkriturit njëkohësisht të dy kulturave të ndryshme. Është shumë e vështirë për fëmijët të lidhen me dy kultura me kaq kundërshti sa kultura meksikane, e cila, së pari është kulturë e çastit (atypëratyshmes), e rrugës, e të përjashtmes dhe kulturës europiane, që është kulturë e shtëpisë, e së brendshmes dhe e rregullave shkollore. Ësh-

“Ndoshta roli i letërsisë sot është t’i bëjë jehonë kaosit”

suar deri sot me nja tridhjetë libra (romane, ese, përmbledhje novelash, përkthime), pasqyron shqetësimet e tij ekologjike, revoltën kundër fanatizmit së mendimit racionalist oksidental, tërheqjen prej botës indiane të Amerikës, të cilën e zbuloi shumë herët dhe që ia ndryshoi jetën kryekëput. Në këtë intervistë ai rrëfen këtë takim, por gjithashtu rrënjët nga Mauricius, bashkëlidhen me metisët, conceptimin e romanit dhe të letërsisë.

F D : Veprën tuaj e kanë cilësuar si mistike, filozofike, gjer edhe ekologjike. A e gjeni veten në këto cilësime?

J. M. G. Le Clézio : Është e vështirë të përcaktosh atë çka e bën vetë. Nëse do të më duhej të përshkruaja librat e mi, do të thosha që është përcaktimi që më afrohet më shumë. Thënë ndryshe, për mua nuk është fjala thjeshtë të shprehësh ca ide, se sa të shprehësh atë çka je dhe atë në çka beson. Kur shkruaj, në thelb kërkoj të përkthej lidhjen time me të përditshmen, me ngjarjen. Ne jetojmë një një epokë të turbullt, ku na ka zaptuar kaosi, rrëmuja e ideve dhe imazheve. Roli i letërsisë sot është ndoshta t’i bëjë jehonë këtij kaosi a çrregullimi.

F D : A mundet letërsia të veprojë tek ky kaos, rrëmuje, ta shndërrojë atë?

J. M. G. Le Clézio : Nuk e ka më

kryelartësinë, (arrogancën) të besojë, si në epokën e Sartit, ku një roman të mund të ndryshojë botën. Sot shkrimtarët munden veç të vënë në dukje pafuqinë e tyre politike. Kur lexohet Sartri, Kamyja, Dos Pasosi, apo Shtajnbeku duket qartë që këta shkrimtarë të mëdhenj të angazhuar kishin një besim të patundur në përkryerjen e qenies njerëzore dhe në fuqinë e shkrimtarisë. Më kujteth kur isha 18 vjeç, lexoja në gazetën *Express* editorialet e nënshkuara Sartër, Kamy, ose Moriak. Ato sihin ese të angazhuara, të cilat të tregonin udhën e duhur. Kush mund ta përfytyrojë, se një editorial në gazetë mund të ndihmojë të zgjidhësh problemet, që ne na prishin ardhmërinë? *Letërsia bashkëkohore është letërsi e dëshpërimit.*

F D : Nëse ju emërtojmë shkrimtar të paklasifikueshëm, kjo mbase ndodh ngaqë Franca nuk ka qenë asnjëherë burimi juaj i vetëm i frymëzimit. Romanet tuaja juajnë, marrin pjesë në imagjinaren e globalizuar. Pak si vepra e një Remboje, a e një Segaleni, autorë, për të cilët kritika letrare franceze ka hequr gjithmonë këq për t’i përcaktuar.

Le Clézio : Në krye të herës, po ju përgjigjem që nuk më merakos fare të qenët i paklasifikueshëm. Vlerësoj se romani ka si veçori kryesore të jetët i paklasifikueshëm, domethënë të jetët një

gjini polimorfe, që pjesëmerr në një farë kryqëzimi, e një tharmimi idesh, i cili, në fund të fundit është pasqyrimi i botës sonë shumëpolëshe. Me të thënë këtë, ndaj me ju mendimin se institucioni letrar francez, trashëgimtar i mendimit të ashtuqajtur universal të Enciklopedistëve, ka pasur përherë prirjen e pavend të marginalizojë gjithë mendimin e kahehshëm, duke e cilësuar si "ekzotik". Remboja, Segaleni, etj. kanë bërë të tyren në kohën e vet. Po ashtu, ende sot shkrimtarët e Jugut nuk janë botuar tek ne, hiq rastet kur kanë pranuar të kufizohen në kategorinë "ekzotike". Shembulli që më vjen ndër mend është ai i mauricianit Ananda Devi, veprën e të cilët e kam mbrojtur, kur isha në Komitetin e Leximit të botimeve *Galimard*. M'u patën përgjigjur, se dorëshkrimi i tij nuk ishte aq ekzotik sa duhej!

F D : Prej nga vjen tek ju ky joshje nga tjetërkundit?

Le Clézio : Kultura oksidentale (perëndimore) është bërë tepër monolite. Ajo privilegjon gjer në acarim anën e saj qytetëse, teknike duke penguar kësaj zhvillimin e formave të tjera të shprehjes: besimin fetar, ndjenjat, sa për ta shembulluar. Gjithë pjesa e papërshkueshme e qenies njerëzore është fshëhur në emër të racionalizmit. Është kjo marrje e ndërjegjes që më ka shqetësuar më së shumti.

F D : Sot ju jetoni mes Albukerkut, në Nju

Në këtë tjetërkundin që ju keni kërkuar, Meksika në veçanti dhe bota indianoamerikane në përgjithësi, zënë një vend të mbizotërues. Si e keni zbuluar Meksikën?

Le Clézio : Më dërguan në Meksikë për të kryer shërbimin ushtarak. Për ato dy vite kam ndënjur në atë vend, kam rastin të udhëtoj. Kam shkuar veçanërisht në Panama, ku kam takuar les Emberas. Kalova katër vjet (1970-1974) me këtë popullatë indiane të pyjeve. Ishte një përvojë drithëruese, sepse zbulova një mënyrë jetese, ë s'kishte fare të bënte me atë që kisha mundur të njihja në Europë. Emberasit jetojnë në harmoni me natyrën, me mjedisin rrethues, me vetetaven pa patyur megjithatë nevojë t'ju referohesh një autoriteti juridik, apo fetar çfarëdo goftë. Kjo m'u duk e çuditshme dhe ndërsa pas kthimit desha ta tregoj kohezionin social të kësaj bashkësie, kritikët më ofruan të qenët naiv, të isha thjehëtues dhe të bija në mitin e "egërshanit të mirë", ndërkohë që, ky nuk ishte fare qëllimi im. Nuk mund të thosha kurrë për ata njerëz, me të cilët kam jetuar se ishin të egër, as që ishin të mirë. Ata jetonin sipas të tjera kritereve dhe vlerash. Librat e mi janë ajo çka më shembëllen më shumë.

F D : Sot ju jetoni mes Albukerkut, në Nju

të bash përplasja e kulturave ajo çka kam dashur të tregoj.

F D : Po përse atëherë "romancë"?

Le Clézio : Është fjalë pak ironike për të përshkruar gjendjet tragjike. Libri përbëhet nga shtatë novela; janë rrëfime të ërrëta. Në romancë ndjesia mbizotëron mbi të vërtetën sociologjike. Mendoj se roli i novelës është të vërë në pah këtë shkarje të vazhdueshme mes ndodhjeve sentimentale dhe botës shoqërore, botës së vërtetë. Nga ana tjetër, gjithë nvelat e këtij vëllimi janë ndodhi të ndryshme që i kam përshatur. Pra, bëhet fjalë për histori të vërteta. Ato zotërojnë atë pjesën "lule blu", që gjendet po ashtu në faqet "fakte apo ndodhi të ndryshme" të gazetave.

F D : Në librat tuaj, kufiri ndërmjet gjinive megjulohet është larg rrëfimit romanor klasik. A besoni se romani si gjini, trashëguar nga shek. XIX, mbetet tepër i shenjuar prej origjinës borgjeze dhe koloniale dhe se ai nuk mund të bëjë tjetër, veçse të vetdijësohet për ndërliqshmërinë e botës postmoderne, postkoloniale?

Le Clézio : Romani është faktikisht zhanër borgjez. Përgjatë tërë shek. XIX, ai ka mishëruar me madhësi fatet dhe fatkeqësitë e botës borgjeze. Mandej erdhi kinemaja. Ia mori kreun

dhe u shpërfaq si një mjet përfaqësues shumë më i frytshëm i botës. Shkrimtarët, pra, kërkuar të zgjerojnë flurudhën e llojit romanesh, duke e bërë një vend të shprehjes së ideve, të ndjenjave. Duke bërë këtë ata u ndërgjegjzuan se sa ky lloj letrar është i ndikueshëm, fluid, duke u gatitur kollaj eksperimenteve formale. Që atëhere, çdo brez e ka ripërtërirë romanin, e ka rishpikur duke sjellë përbërës të rinj. Mendoj për romancierin maurician Unuth, që e kam zbuluar së fundi me rastin e daljes së përthimit të librit të tij të radhës. Është një roman që, nga njëra anë të kujton Eugène Sud. Unuthi përdor formën e romanit klasik, por të pëmbysur, duke ndërfutur elemente epikë, këngë dhe një ritëm që i përket poetikës indiane. Kjo të çon te *Çifuti ëndërrues* ose te *Misteret e Parisit*, të rishikuara dhe të ndrequra nga Ramayana 1.

F D. : Romanet tuaja kanë gjithashtu anën autobiografike. A e keni përshlyer se jeni arkivist i vetë historisë suaj, përvojës suaj jetësore?

Le Clezio : romancierët e mi të parapëlqyer janë Stivensoni dhe Xhoysi. Ata gjetën frymëzimin që në vitet e para të qenies së tyre. Nëpërmjet të shkruarit, ata ruajtën të shkuarën dhe përpigën të kuptojnë "përse-të" dhe "si-të". Kur lexon *Ulliksin* ke përnjimend mbresën se Xhoysi nuk ka për qëllim të tregojë çastin e tanishëm, por gjithëkëndë që ai mbart në vetevetë, gjithë çka e ka formuar. Ai ringjall çdo zhurmërimë rruge, dramocak e bisedës, ndëshkimet trupore prej shkollës, që e turpërojnë ende si idengulitje. Naipauli gjitha rikthehet me imagjinatë të vitet e para të formimit. Letërsia është e fuqishme bash atëbotë kur ia del të shprehë ndjesitë, përvojat, idetë dhe zhgënjimet e para.

FD: Shpesh, duke ju lexuar, të krijohet përshtypja se personazhet tuaja kërkojnë një atdhe, atdhe, i cili e kapërcen konceptin tradicional dhe paksa të ngushtuar të kombit. Salman Ruzhdi flet për një atdhe imagjinar, çka sjell në kujtesë raportin e ri që shkrimtari në mërgim rreket të vendosë me vendin nga ku vjen. Në ç'pika përngjet atdheu juaj imagjinar me juve?

Le Clezio : Unë e quaj veten të mërguar, pasi familja ime është krejt mauriciane. Për breza me radhë ne jemi ushqyer me folklorin, kuzhinën, legjendat dhe kulturën mauriciane. Është një kulturë mjaft e përzirur, ku gërshtohen India, Evropa dhe Afrika. Unë kam lindur në Francë dhe jam rritur aty me këtë kulturë. Jam rritur me atë, që më thoshin se gjetkë mishërohej atdheu im i vërtetë. Një ditë do të shkoja dhe e dija se ç' do të gjeja atje. Në Francë, unë gjithnjë e kam menduar veten si një "copë e sjellë". Si kundërpeshë, unë dua gjuhën frënge, që ndoshta është atdheu im i vërtetë. Mirëpo, nëse flasim për Francën si komb, më duhet të them, se rrallë jam bërë njësh me nevojat e saj.

*Përktheu : Anton Bido

POEZIA

NGA DEMIR GJERGJI

Brenda Njeriut

-Sime bije, nënë-
Metroja shpon dritën, e çan
mespërmas
Me fetusin e natës që gdhihet
mëngjes.

Mars, 2018

NJË FYTYRË

TJETËR...

Më sulmonte një fytyrë tjetër,
Ndërsa ndjeja po atë zemër!
Në oazin e lotëve të vjetër,
Sytë dilnin tepër!
Qenka herët, ende herët,
T'i lë lamtumirën verës,
Ta nis ftesën për festën vjeshtës.
Ma zë pamjen një fytyrë
tjetër...
Vera baret brengës,
Vjeshta bredh në breshër...

BETEJA

Ishte ai vit, ishte ajo ditë me
orën e ligë,
Që m' u bënë udhë, të ikja prej
teje...
Ndërsa shembem natën si vigan
mbi vig,
Ende shpirti s'jepet mes asaj
beteje

MJEGULLA

Ngrihet
Frymëmarrja e gjumit të ujit,
Si gënjeshtra,
Fjalë pas fjale,
Nga buzët e tua të bukura.
Bie mbi pyetjen time
Për sinorët dhe orët,
Prej nga nisen meteorët.

GJUMË I TRAZUAR

Endrra
Erdhi,
Më pa
E të tha:
"Në tjetër shtrat...
U shtri yt atë!"
U zgjove.
Kërkove nënën,
Nga frika mos ishte në gjumë
Dhe shihte të njëjtën ëndërr.

VAJTIM PËR
JASEMININ

E vranë jaseinin.
Ia thanë lulëzimin!
Nga dheu e shkullën,
Si plumbin prej gjurit!
Si gjëmën prej trurit,
Si nderin prej burrit,
Si ëndrën prej gjumit,
Si flokë kufome, rrënjët e
njoma,
Me lulet e vogla lotojnë aroma.
Në dheun e shkretët, të rënë në
koma,
Goja e gropës s'ka folur akoma!

HEMATOMË

Hija e Tokës
Shkeli e shkoi...
P-lojës sonë!
Nën lëkurë, në gjak,

Ky cikël me poezi sjell krijimtarinë e autorit Gjergji në ditët tona. Ka disa kohë që fle në arkivin tonë, ndërsa e sjellim në të gjithë përbërjen e vet për publikan. Autori është një lirik i paqtë, që mundohet edhe trishtim ta mbajë në një rregjistr të pranueshëm



Pa-gëzime

Më çel një zambak!
Mëngjesi u gdhi...
Mbylli sytë e fli,
Mbi zambak të zi!
Mbama dhimbjen ti!

MATERIE E
TEJDUKSHME

Ajo kthjellohet, kristal i
tejpamshëm fundemajë.
Flijohet, që bredhin ta shoh
matanë në pllajë.
Dhe druri i mëçëm shkrihet në
gaz e shkrehet në vaj,
Ma thotë gjithçka që dua të gjëj
në qenien e saj.

ANA, MOS U RRRIT!

-Për Ana Iks-
Ana, vajzë e vogël,
Burrë isha unë.
Ia lëmoja flokët:
"Mos u rrit më shumë!"
Lutesha përditë,
Trembesha çdo vit:
"Anë, mos u rrit,
Rri këshut, si dritë!"
Ditë e vite vanë.
Lutjet shkuan dëm.
Ana, tashmë zanë,
Pret të bëhet nënë.
... Anën shoh e fshihej,
Ta takoj kam frikë...
S'pyesin se ku ndizen
Yjtë e dashurisë...

TRINI PA SHENJT

Fryma fiktë fenerin.
Fillimin e flakte në fund.
Fjala fillonte të falej,
Nga buzët e Atit, nën gunë...
Nën blozën e strehës, mbi
trung:
Frymë gjithçka... dhe fjala
gjithkund.
Gjithëkush, udhëtar pa gjurmë
në gjumë,
Dhe Mëma, dhe Ati, dhe shenjtët
e lumë.
Kur ndrite ti në natën mbi
shkrumb...
Fryma u shfaq te dallga si
shkumë,
Fjala foli me urat mbi lumë.
Mëmë e ndjeve veten. Ati isha
unë.
Shenjtoret e shumtë s'na
hynin në punë.

GOJËDHANË

Ajo ishte një njeri, shtrirë në
një histori.
Nis një gojë ta tregojë, ta
këndojë.
Dhe vesh më vesh, dhe gojë më
gojë...

Alfabeti përmbi letër s'mundi ta
fiksojë.

Dhe rron, dhe vallëzon, dhe
fluturon,
Frymë me frymë, shpirt më
shpirt, qenies sonë.
Dhe je ti kjo histori,
Ikur larg nga vizatime,
pergamena, shkronja, shkrime,
Veç robinjë e frymës sime!

TË PËRHERSHËM

Do të zhvishemi dhe një herë
Nga meshat, nga peshat, nga
teshat,
Nga hyjtë e hyjneshat.
Pa gjak e pa eshtra,
Pa shqisa, qeliza, gënjeshtra
Do të shihemi dhe një herë
Veç erë në atmosferë,
Të gjithëgënjeshëm, të
përhershëm për t'u ndërër,
Si atëherë, kur vrapim mbi
tastierë!

NË KUJTIM TË SAJ

Fosil vetëtime
Ekzili bubullime,
Idil cicëtime,
Në prill psherëtime.
Skalitja statujën, o dhimbje,
Ringjalle me frymën time!

SKAJE SAHARAJE

E vetme, Ajo pa Të...
Dheu pa qiellin tashmë.
Veç hëna, që hijet përzë
Dhe dielli, që flakën i vë.
Si flokët shkul pyjet planeti,
Themelesh rrënohet qyeti.
Në helm të vetvetes, akrepi,
Fundin e jetës e gjeti.
I vetëm! E vetme! Të vetëm!
Aisbergët mbi xhunglat u
shembën.
E vetme! I vetëm! Të vetëm!
Në skaje Saharaje u tretën!

DJALI I VETMISË

M' u bënë n'andërr
Në petkun e hijes së vet!
I askujt. Prej askund. Për
kurrkund.
As fmi, as plak. As skillav, as
mret.
Veç dhëndër,
Që pret e s'din ç'ka pret.
...
Kjo andërr, sa net e sa vjet,
Vjen e prap' m'le shkret.

DOLLI DETARËSH TË
DEHUR

Sa shumë udhë për këngën
tonë!

Sa pak veshë e dëgjojnë!
Hapësirë pa fund e skaj,
Sa pak shenja brenda saj!
Ora shekull vjen për jetën,
Jeta endet detesh vetëm.
Shfaqet toka! Zbrazen gota!
Hapen porte... Kalben porta...

ME ZË TË LARTË

Me zë të lartë qesh kjo vajzë.
Me zë të lartë në bar.
Me zë të lartë,
Se është e bukur,
Me zë të lartë,
Se është e lumtur.
Me zë të lartë...
Dhe kthjellosh si dita jashtë.
Me zë të lartë në bar:
Tri tryeza pranë,
40 vjet matanë,
1 mijë kode larg;
Udhëtar i jam,
Koshta të saj.

UDHA NËN BORË

Udhën për të ti për mallshëm e
mora.
Mbi udhë, e virgjër, dëbora!
-Mos e shkel, he të shiftohet ora!
Në ëndërr dëgjoja...
Yt flatra m' i nise saora,
Të vija mbi erërat të ftohta.

18- PRUSH

I AKULLT

-Një herë u deshëm,
Një Erë u ndeshëm!
(Nga Dhjata Jonë)
Fytyrë e qeshur nën maskën
që qan,
Maskë që qesh mbi lot e mërzë.
Dhe mali nën borë që mban një
vulkan,
Dhe yjt mbi re si prushi nën hi...

Dhe veshja e hollë fsheh vjeshtën
me mollë!

HAPA NË NGRICË

M.
Ti shkel vetëm në rrugicë...
Hija dobët shket mbi ngricë.
Se nga qielli zbret pak dritë...
Sa ç' më ke atje në shpirt.
Poshtë akujsh fle një farë,
Siç rroj unë brenda teje.
Thua do të mbijë vallë,
Të na bëhet hije vere?

VDEKJA E ALPINISTIT

I shtrirë në sallë,
Mbi cohë të bardhë.
Tej, mali përballë,
Nën borë, i gjallë!

A

ARGUMENT

NGA BEN ANDONI

Ka pasur kundërthënie të shumta për godinën e Teatrit, por ajo që ra në sy më shumë këtë fillimjavë ishte një dhe vetëm një. Mungesa e transparencës. Artistëve iu tha se nuk kish të projekt, se teatri ishte në gjendje të rëndë, ndërsa çuditërisht më 12 Mars 2018, një projekt *impozant* i shpalo para syve. Pas kësaj, nuk u kërkuva falje për kundërthëniet e projektit, ashtu si nuk u paraqitën projekte alternative.

Teatri aktual Kombëtar gjendet në një parcelë të qendrës së kryeqytetit dhe kap hapësirën e mijëra metrave katrorë tokë publike. Teatri është i konceptuar si një ngrehinë e përbërë nga dy dykatëshe pothuaj identike. Projektin e ndërtoi arkitekti italian Giuglio Berté gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe ngrehinat kanë shërbyer herë si kinema, herë si ndërtesë gjyqi pas lufte, shfaqje të ndryshme, Bingo, por jetëgjatësinë më të madhe e kanë si Teatër Kombëtar, të paktën që nga viti 1947.

Është një fakt i pamohueshëm se ku kapet aktualisht Qeveria dhe Bashkia e Tiranës për prishjen e tyre: Ndërtesat janë të degraduara, nuk kanë qenë të konceptuara për teatër dhe nuk mund të mirëmbahen ashtu siç duhet. Madje, pak javë më parë qeveria u kërkoi aktorëve të largohen duke pretenduar se një godinë tjetër priste për ta. Ndërkohë shqetësimi i madh i komunitetit të artistëve dhe intelektualëve ka qenë se çfarë do bëhet me këtë hapësirë dhe pse po i përdorin në këtë mënyrë?! Po ashtu, me atë formë që ka ngrehina mund të rikoncepohen, duke ruajtur jo thjesht historinë por edhe funksionet.


Të jenë vallë kaq naivë artistët? Të jenë kaq të paskrupullit politikantë? Duke e nisur nga këta të dytë është afërmendsh që politikantët shqiptarë nuk njohin as një skrupull. Jo thjesht për ato që artikulojnë por për të gjithë sjelljen e tyre në këto 27 vjet Demokraci. E tillë ishte edhe këtë 12 Mars, kur i ndanë artistët e ftuar që me ftesat dhe diferencimi tregoi se mungesa e transparencës ishte prezentë edhe në këtë ditë. Si zakonisht, iu dha pesha kryesore autoritetit të kryeministrit Edi Rama, që prerë tha se nga këtu fillon projekti i ri. Më pas iku, duke ua lënë në gojë fjalën atyre që donin të artikulonin diçka. Robert Ndrenika me peshën e moshës dhe profesionit artikuloi drejt, por nxorri edhe shqetësimin real: Artistët ishin përdorur dhe kjo nuk ishte e drejtë, sepse projekti që kishte parë nuk ishte fare ky. Arkitekti danez, Bjørke Ingles, që e prezantoi projektin në mënyrë profesionale ndaloj edhe në vlerësimet e tij për të rrëfyer se e vlerësonte Tiranën që po ndryshon në një qytet sa më të jetueshëm për banorët e vet.

"Kam ardhur këtu për herë të

Artistët thonë se do të marrin vetë përsipër ndërtimin e teatrit dhe sipas modelit klasik britanik do të bëjnë thithjen kolektive të parave. Sesa do t'ia dalin do të shikohet, por për një gjë duhet të jemi të qartë: Shteti shqiptar duhet të ishte i hapur me ta dhe bashkëpunimi real për Teatrin nëse do të ishte kaq i pastër nuk do të kishte kaq shumë zhurmë.

Duket se çështja "Teatri" do ketë zhvillime, po për një gjë do të mbahen mënd të gjithë, se në këtë vend transparenca është një sëmundje që nuk do kurohet kurrë lehtë...

Teatri i ri Kombëtar, realiteti i të ardhmes do nxjerrë të vërtetën



parë 7 vjet më parë dhe e pash Tiranën që kishte filluar të gërmonte nga energjia dhe transformimet por ishte një qytet krejt tjetër nga ai që shoh sot. Unë kam që nga ajo kohë që vij të paktën 1 herë në vit dhe është frymëzuese për mua që të shoh një qytet dhe një komb kaq të mobilizuar në një përpjekje për ta bërë qytetin, hapësirat dhe rrugët e tij më të banueshme dhe më të këndshme për njerëzit që jetojnë këtu", tha Ingles.

Me shumë pathos foli edhe për projektin e Teatrit Kombëtar në

këtë transformim të Tiranës. Në fakt përballë ishte mirë të kishte grupet e interesit shqiptar dhe mbi të gjitha një përballje reale me profesionistë, por kjo nuk u mundësua. Ashtu si nuk u mundësua një projekt tjetër alternativ. Kjo është një nga vuajtjet reale të Tiranës: Mungesa reale e transparencës.

Pavarësisht teatrit të fundit me teatrin, deri më tani na ka dalë plani i ngritjes së disa kullave më pas dhe një godinë e re e teatrit, që është përfolur disa herë. Më keq nga të gjitha u harrua premtimi i

zero indërtimeve.

Në Shqipëri gjithnjë e më shumë mbetet shqetësues mënyra e bashkëpunimit të ndërtimit me koncesion ose siç thuhet rëndom Partneritetit-Publik-Privat. Koncesionet kanë një pasqyrim jo të mirë në vendin tonë. Dhe, jo më kot, Fondi Monetar Ndërkombëtar e këshilloi qeverinë Rama "të vetëpërmbahet nga nënshkrimi i kontratave të tilla" për shkak të përfitimeve dhe kostove të paqarta për taksapaguesit. "Kudri i qeverisë për përzgjedhjen dhe priorizimin e projekteve të investimeve, si dhe për vlerësimin e kostove dhe rreziqeve fiskale, mbetet i pamjaftueshëm, sipas vlerësimit të FMN", tha përfaqësuesi i FMN në Tiranë Jens Reinke.

Por kjo kuptohet se nuk ka luajtur ndonjë rol sepse në kokën e pushtetarëve është vendosur: Teatri i ri sipas Ramës do jetë sa trefishi që është sot dhe me oratorin e vet pompoze kryeministri shprehet se salla ekzistuese do të shem-

bet dhe do të nisë ndërtimi i godinës së re. "Ndërtesa do shembet dhe mbi gërmadhat e të shkuarës do ngrihet teatri i ri kombëtar. Kushtet e teatrit sot janë posh-tëruese për artistët. Nuk do jetë teatër me kullë, por s'do kishte asnjë mëkat të ishte nën kullë, se njerëzit shkojnë të shohin teatër dhe jo kullë. Nga 3000 metra katror rrënoja do të kemi 9 mijë metra katror. Nga 1 sallë do të kemi 4 salla për shfaqje". Anipse janë katër salla. Ndaj, pas pak fjalëve, kryeministri iku duke e shkarkuar të gjithë peshën e vet në sallën që nuk pëtitente nga përdorja jo normale.

Nuk po futemi në elementët të detajuar, por një gjë është e dukshme, kushtet e teatrit të sotëm, megjithë përmirësimet dhe shtyrjen që po i bëjnë artistët prej kurajës së tyre le shumë për të dëshiruar. Aman, kjo nuk do të thotë që duke shfrytëzuar këtë të mendohet për tjetërime dhe gjëra ku mungon transparenca.

Artistët thonë se do të marrin vetë përsipër ndërtimin e teatrit dhe sipas një modeli britanik do të bëjnë thithjen kolektive të parave. Sesa do t'ia dalin do të shikohet, por për një gjë duhet të jemi të qartë: Shteti duhet të ishte i hapur me ta dhe bashkëpunimi real për Teatrin nëse do të ishte kaq i pastër nuk do të kishte kaq shumë zhurmë. Tek e fundit, vetë artistët janë të parët që janë të interesuar për teatrin.

Duket se çështja "Teatri" do ketë zhvillime, po për një gjë do të mbahen mënd të gjithë, se në këtë vend transparenca është një sëmundje që nuk do kurohet kurrë lehtë. Rama e dha një provë të qartë për këtë. (Milosao)

LETËRSI

*STAFF MILOSAO

Ka zgjedhur një libër të këndshëm "Pegi" për t'u prezantuar në këto ditë. "Matja e Botës" është roman nga një letërsi e shkruar këndshëm, por edhe qartë. Daniel Kehlmann ka treguar brenda një strukture të qartë pikëvështrimin e tij, por edhe shumë gjëra që lidhen me idenë e vet. Në fakt, libri të jep veç kënaqësive estetike dhe shumë kërshtëri. Duhet thënë se është një nga krijimet më të mira të autorit, që ia vlen të përcillet për publikun tonë. Mbi të gjitha edhe për faktin se autori është një emër shumë i njohur në kohën tonë në letërsinë bashkëkohore.

Romani ngjall emocione thellësisht frymëzuese rreth përpjekjeve të racionalitetit më të

"Matja e Botës" është roman nga një letërsi e shkruar këndshëm por edhe qartë. Daniel Kehlmann ka treguar brenda një strukture të qartë pikëvështrimin e tij, por edhe shumë gjëra që lidhen me idenë e vet. Në fakt, libri të jep veç kënaqësive estetike dhe shumë kërshtëri. Duhet thënë se është një nga krijimet më të mira të autorit, që ia vlen të përcillet për publikun tonë.

"Matja e Botës"

lartë në betejë me natyrën e egër dhe mizore të njerëzimit. Informacioni i përgjithshëm rreth librit Në vitin 1828, Gausi, një matematikan, fizikan dhe astronom ftohet, nga Aleksandër fon Humboldt, eksplorues, gjeograf dhe shkencëtar, të shkojë në Berlin ku do të mbahet një kongres shkencëtarësh.

Gausi nuk ka aspak dëshirë të marrë pjesë, nuk i pëlqen të udhëtojë, njerëzit nuk para i interesojnë; është tip i vetmuar, tejet kritik



dhe gërnjar, por Humboldt është më kokëfortë dhe arrin ta bindë. Takimi midis dy prej mendjeve më të ndritura të Gjermanisë iluministe i jep autorit shkas për të rrëfyer jetët e tyre jashtëzakonshme, që nga fëmijëria e deri në takimin e vitit 1828, duke përfshirë edhe përshkrimin lehtësisht të kup-

Titulli: Matja e botës
Titulli në origjinal: Die Vermessung der Welt
Autori: Daniel Kehlmann
Përkthues: Sokol Mici
Zhanri: Roman
Data e botimit: Mars, 2018
Numi i faqeve: 252
Çmimi: 800 lekë

tueshëm të teorive që kanë themluar gjeografinë dhe matematikën moderne. Autori e shoqëron lexuesin në udhëtimet e Humboldt mbi lundra të pabindura, në majat e maleve më të larta e në thellësitë e kraterëve e shpellave më të fshehta. Lexuesi përumbet në magjinë gjeniale të zbulimeve të Gausit, duke geshur me manitë e tij, duke u pasionuar pas ideve dhe mënyrës se si e shihte botën ai, jetën dhe të ardhmen. Ky është portreti entuziast e i përkushtuar i gigantëve të shkencës dhe kulturës, të cilët zbrisin nga piedestali dhe kthehen në personazhet zbatuesë të një komedie tejet të saktë nga pikëpamja historike. Kritika Stili paksa surrealist e Kehlmann-it është një përzjerje e komedisë, romancës dhe makabres, me dritëhije realizmi magjik, aq sa të duket sikur po lexon Borges-in në "Pyllin e Zi".

The Washington Post Book World Lexohet me një frymë: një veperë vërtet e thellësisht zbatuesë.



...NGA NUMRI I SHKUAR
 "Milosao" e këtij numri ishte shumë akademike. Rëndësën e madhe akademike ia dha shkrimi i Albert Dojës. Akademiku nderuar me një ligjëratë që kish mbajtur në Harvard tregoi klasin por edhe thellësinë e mendimit në ditët tona. *Hulumtimi që po bëj si dhe fuqia e politikës identitare apo rëndësia e populizmit që po merr shumë nga debatet tona në ditët e sotme, siç e pamë javën e kaluar në Harvard, rrjedhin nga diversiteti i madh i mendjeve të njerëzve, jo nga ndonjë parim, vlerë, ide, apo motivim i vetëm dhe i përsosur. Veprimet dhe vendimet e njerëzve, si dhe kërkimi shkencor që bën*

çdonjëri prej nesh, "lindin nga konfliktet dhe negociimet në mes shoqërive të proceseve që vazhdimisht sfidojnë njëri-tjetrin", referoi ai. Shkrimi ishte disi i vështirë për publikun për përjasje, por edhe perceptim, sepse duhej të kesh konceptime para se të afroresh në këto hulli.
 Pas disa javësh që i kishim premtuar në këtë numër pati vend edhe për shkrimin e Mimoza Hysë lidhur me autorin e saj të preferuar Montalen. Moza ka përkthyer "Rastet", por ashtu si ndodh tek ne gjërat shkojnë shpesh fare pa u parë. Ajo e ndjente si peshë që ta shtronte sërish për publikun. Kishte punuar mirë dhe shkrimi

ishte më shumë publicistik, që në një lloj kuptimi sjell edhe historinë e librit "Rastet".
 Feride Papeka na kish sjellë një shkrim tepër të ndërë për poemën klasike "Mahabharata", ku modeli i komentit mitik ka qenë lehtësisht i kuptueshëm, po të nisemi nga origjina mitike e heronjve të rëndësishëm si gruaja e përbashkët, vëllai i madh, babai dhe dy vëllezërit e tij. E mbinatyrshmja aty është një çelës për të zbërthyer shumë enigma..., shkroi ajo. Kishte punuar jashtëzakonisht mirë dhe me seriozitetin e saj. Është mërziur pak që e kemi vonuar, por shpresojmë të na mirëkuptojë.

Agron Shala na kish sjellë një shkrim shumë interesant. Në fakt e solli Stefan Çapaliku, një mik i "Milosao". Titulli ishte i stërgjatë *Uka i Bjeshtëve të Nemuna me traktorin e Uz-inës së Tiranës shkon në Hënë: Odiseja hapësinore e të guximshmëve!* Transgresioni i tij ishte tejet provokativ. Për fat të keq, nuk kishte mirëfilli krijimtari dhe këtë duhet ta rregullojmë në këtë numër. Layout-i kishte punuar pa asnjë impenjim. Duhet thënë se ishte një numër relativisht i mirë që do të shohim sesi do të shkojë në numrat e ardhshëm...

P
POEZIA

Një cikël i shkurtër me klasikët e letërsisë polake e sjellim në këtë numër nën shqipërimin e Prof. Pandeli Çinës, që është shpesh i ndërlikuar me këtë letërsi dhe arrijet e saj më të mira...

WISLAWA SZYMBORSKA

TE SHKRUASH BIOGRAFINE

Çfarë duhet?
 Duhet shkruar një kërkesë, ndërsa kërkesës t'i bashkangjitet jetëshkrimi.

Pavarësisht sa e gjatë është jeta biografia duhet të jetë e shkurtër.

Është e detyrueshme përmbledhja dhe përzgjedhja e fakteve, ndryshimi peizazheve në adresa dhe i kujtimeve që luhaten në data të përpikta.

Nga të gjitha dashuritë mjafton ajo e martesës, ndërsa nga fëmijët vetëm ata që kanë lindur.

Më e rëndësishme kush të njih, sesa kë një ti.

Udhëtimet vetëm nëse bëhen jashtë shtetit. Përkatesi për diçka, veç pa thënë përse. Dekorimet pa thënë për ç' arsye.

Shkruaj ashtu, sikur të mos kesh folur kurrë me vehte dhe të jesh anashkaluar nga larg.

Shmangi me heshtje qentë, macet dhe shpeshët, ato rraquet për kujtim, miqtë dhe ëndrrat.

Më sakt çmimi se vlera dhe titulli se përmblajta. Më sakt të dihet numuri i këpucëve, sesa ku po shkon ai, ky për të cilin e heq veten.

Për këtë është një fotografi me vesh të zbuluar. Vlerësohet trajta e tij, jo ajo çka dëgjohet. Çfarë dëgohet?
 Zhurma e makinerve që grijnë letër.



WISLAWA SZYMBORSKA

RECENSION I NJE VJERSHE TE PASHKRUAR

Në të parat fjalë të kësaj vepre autorja pohon se Toka është e vogël, ndërsa qielli tepër i madh, ndërsa vje "në të ka më tepër se ç'dduhet".


Në përshkrimin e qiellit ndjehet një paafësi, autorja humbet në një hutim të tmerrshëm, goditur nga vdjerrja e shumë planeve dhe sakaq në mentë e sajë (le të shtojmë: jo të përpiktë) nis të lindë një pyetje vallë ndërkaq mos jemi vetëm nën këtë diell, nën gjithë dijetë e botës?

Për një reng të llogarisë me gjasa! Dhe të bindjes së gjithanëshme sot! Përkundra fakteve kokfortë, që ndonjë ditë mund të bien në duartë e njerëzve. Ah, poezia.

Ndërkaq profetja jonë kthehet në Tokë, në atë planet, i cili mbase "vërtitet pa dëshmitarë", me të vetmen "science fiction në të cilën kozmosi mund të qendrojë".

Dëshpërimi i Paskalit (1623 – 1662 shënimi ynë) i duket autores të mos ketë aspak konkurrencë me Andromedën as me Kasjopean. Ekskluziviteti i zmadhon shumë gjërat dhe të detyron, pra, del problemi si të jetohej et cetera, sepse "zbrazia këtë nuk e zgjidh për ne". "O Zot, i thërret njeriu vëhtes, ki mëshirë për mua, më ndrit!"...

Autoren e bren mendimi për jetën e shthurur aq lehtë, sikur të ishte në një humnerë pa fund. Për luftërat, të cilat – për mendimin e sajë me këmbëngulje – janë humbur përherë në të dy anët.



ADAM ZAGAJEWSKI

PER VEHTE NE DITAR

Sthrihet, sthrihet re e hirtë, një lule bozhuri po cel. Ty asgjë s'të lidh me këtë tokë, asgjë s'të lidh me këtë qiell.

Oborri përçarjet në vapë, një mace gogësin në verandë. Ti ecën në rrugicë, blirë të lulëzojnë, veç nuk e di, në cilin qytet,

nuk mban mend, në cilin vend. Ndrinjë krahet e gurgujve të lehtë, nata vjen me hap të butë, gonxhet e trëndafilët fshihen.

Ti je vetëm një ëndërr, shëmbëlltëry, je vetëm një dëshirë. Kur të zhdukesh, do të zhduken retë, kujtim i bronxtë do të mbetesh.

Do të banosh në lumenj dhe në ato pemë, mes hijeve, veç do zhytesh në dhe, në dhe, në dhe.

Përktheu nga origjinali Pandeli Çina

WISLAW SZYMBORSKA

PORTRET GRUAJE

Kjo duhet të jetë për tu zgjedhur. Të ndryshohet, që vetëm asgjë të mos ndryshojë. Kjo është e lehtë, e pamundur, e vështirë, ia vlen të provohet.

Nëse duhet sytë i ka, herë të kalter, herë të hirtë, të zinj, gazmorë, tërë lotë pa ndonjë shkak. Fle me të si e para nga bregu, e vetmja në botë. I lind atij katër fëmijë, asnjë fëmijë, një. Naive, veç ia del mbanë fare mirë. E pafuqishme, por do ta shtyjë. Nuk ka krye mbi supë, por atë do ta ketë. Lexon Jaspersin dhe shkrime grash. Ajo nuk e di përse i duhet kjo vidhë dhe do që të ndërtojë një urë. E re, si zakonisht, e re, përherë ende e re. Mban në duar një harabel me krahe të thyer, ka paret e veta për një udhëtim të largët dhe të gjatë, një hanxhar për mish, një kompresë dhe një gotë me vodkë. Ku po vrapon ajo kështu, vallë, nuk është lodhur? Por jo, vetëm pak, shumë nuk prish punë. Ajo ose e do atë, ose ka gulumuar. Për të mirë, jo për të mirë dhe për mëshirë të Zotit. ***

Për "tu bërë zot" (sic!) njerëz mbi njerëz. Njëpërjet veprës shndrit synimi moral. Nën një penë më pak naive ajo ndofo ta të vezullonte.

Mjerisht, ç'të thuash. Kjo tezë që në themel është e rrezikshme (mosvallë nuk jemi ne të vetmit nën diell, nën gjithë ata diej në botë) dhe zhvillimi i sajë me një stil të çlirët (një përzierje e sublimes me të folmen e rëndomtë) bëjnë, që dikush do ta besojë këtë? Me siguri askush. Pikërisht.

Opinion *i* Ditës

Shqipja, gjuhë e dytë edhe në Malin e Zi

Nga Spartak Ngjela

(vijon nga faqja 1)

... të asaj që do të arrinin shqiptarët atë ditë?

Ky akt sot ka ngritur peshë guximin dhe heroikën shqiptare drejt historisë së re të shqiptarëve në të gjitha trevat e Ballkanit Perëndimor.

Ja, këta kanë qenë dhe këta janë armiq të tanë shekullorë që, pasi u pranuan nga të parët tanë si punëtorë, gjetën rastin dhe pushtuan territoret tona.

Por tani janë në fundin e tyre. Bënë gjithçka kundër shqiptarëve me forcën e Rusisë, por tani që shqiptarët mbijetuan, sigurisht që do të shkojnë në vendin ku i takon të jenë.

Por çfarë do të ndodhë në Ballkanin Perëndimor?

Do të vijojë i njëjti proces: identifikimi i shqiptarëve dhe ngritja e prestigjit të tyre nëpërmjet gjuhës shqipe. Në këto treva sot pritet që të identifikohen rreth 8 milionë shqiptarë. Pa llogaritur arvanitasit dhe çamët e Greqisë.

Në këtë kohë ka filluar e do të vijojë ngritja e dinjitetit kombëtar shqiptar në Mal të Zi.

Plava Gucia dhe Tuzi janë të parat që po gjallërojnë në funksion të gjuhës shqipe. Por kështu do të vijojnë edhe Ulqini e Tivari, e bashkë me të edhe të gjithë fshatrat e shumtë shqiptarë. Por edhe shqiptarët në Podgoricë.

Që të gjithë shqiptarët e Malit të Zi kanë kaluar një jetë të trishët, pa përkrahje dhe me një dhunë të tejme drejt asimilimit. Kurse shteti shqiptar, nuk ka bërë asnjë lloj mbrojtje në një shekull e gjysmë. Dhe po njëlloj kudo.

Tani që përfundoi procesi i gjuhës në Maqedoni, sigurisht që ky do të hapet edhe në Mal të Zi.

Tharmi shqiptar shumë shpejt do të shfaqet i plotë në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Ky fillim shekulli do të hyjë në histori, pa dyshim, si koha e madhe e shqiptarëve që ka nisur, por do të vijojë edhe më me forcë në ngritje të dinjitetit, gjuhës dhe të drejtave shtetformuese shqiptare në të gjitha këto treva.

II. Vendosja e gjuhës zyrtare shqipe në Maqedoni, keni për ta parë se shumë shpejt do ta krijojë normalisht procesin shqiptar edhe te ortodoksët shqiptarë por edhe te katolikët shqiptarë në shtetin maqedon. Janë bërë gati që tani që këta të shpallen si shqiptarë, në një popullsi që i kalon 300 mijë persona, por që si proces do të vijojë. Kjo është arsyeja e sjelljes banditeske të Gruevskit.

Shpejt shqiptarët do jenë shumica e popullsisë në shtetin maqedon.

E njëjta situatë ka filluar dhe do vijojë edhe në Malin e Zi, ku deri tani janë identifikuar vetëm shqiptarët e njohur si të tillë, me 30



mijë banorë.

Procesi që ka nisur mendohet që ta çojë popullsinë shqiptare myslimane, ortodokse dhe katolike deri në 100 mijë banorë shumë shpejt, dhe sigurisht që do të vijojë të rritet, si pasojë e fenomenit shqiptar që ka filluar të diktojë me forcë në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, në funksion të shpalljes shqiptar dhe jo sllav.

Mali i Zi është shtet që si pasojë e flirtit të Rusisë me shtetet e mëdha europiane e rriti territorin malazez nga 1800 km² në 18000 km² territor, dhe e gjithë rritja ka qenë bërë në raport të drejtë me

dhunën, vuajtjen dhe pastrimin etnik kundrejt shqiptarëve që jetonin prej mijëra vjetësh në vendin e tyre etnik iliro-shqiptar.

Nuk duhet të harrohet se historia e aneksimit të këtyre trevave shqiptare ka krijuar heroikën shqiptare të Lidhjes së Prizrenit dhe të luftërave të mëdha të malësorëve shqiptarë që janë të përjetësuarat te "Lahuta e Malcisë" e poetit tonë kombëtar Gjergj Fishta. Por edhe në historinë e Shqipërisë si heroikë historike e pashoqe në Europë, që fillon afirmimin shqiptar në rrafsh të historisë botërore.

III. Ja, kjo është gjendja e re-

formimit shpirtëror të shqiptarëve në Ballkanin Perëndimor, dhe e ngritjes në fuqinë e saj të gjuhës shqipe, si vetësimi historik që ka ardhur kryesisht si magia e gjuhës shqipe.

Ky është proces që do vijë të ecë progresivisht për të identifikuar domosdoshmërisht të gjithë shqiptarët në Ballkanin Perëndimor.

Dhe ky fenomen do të marrë ngjyrimin e plotë historik dhe real, me forcën që u shfaq e po progredon në Maqedoni, kur të vijë e të shfaqet po kështu edhe në Greqi.

Edhe këtu ka nisur fenomeni shqiptar, por tani për tani është ende në stadin e fermentimit. Shumë shpejt do të shohim fenomenin shqiptar edhe këtu njëlloj si në Maqedoni.

Por në këtë histori nuk janë më qindra mijëra shqiptarë të paidentifikuar mes magjisë së gjuhës së lashtë shqipe, por miliona të tillë.

Kur bota të marrë vesh se cilët janë shqiptarët, arvanitasit dhe çamët e Greqisë, atëherë vetë historia e qytetërimit evropian do ta gjejë veten e vet realisht.

Fenomeni shqiptar i nisur me Pavarësinë e Kosovës patjetër që do ta mbushë plotësisht trajektoren e vet në Ballkanin Perëndimor.

HOROSKOPI

DASHI

Dashuria do t'ju godasë në mënyrë të parëzistueshme, thellësisht, ndoshta edhe pak në mënyrë të misterhme, por e sigurt që do të jetë një përvojë e këndshme. Në punë bëni bilancin dhe verifikoni nëse jeni duke bërë atë që doni. Kërkoni gjithmonë të ndiheni mirë.

DEMI

Merrni vendimet duke ruajtur ekuilibrin dhe duke shmangur reagimet gjaknxe të ta. Duhet patjetër të tregoheni të kujdesshëm. Nëse do t'ia lejoni, një familjar do të jetë i lumtur t'ju ndihmojë. Mos lini që kjo mundësi t'ju ikë. Përfitoni.

BINJAKET

Bashkëprejmi i Plutonit, Uranit dhe Venusit ju favorizon që të rinovoni disa gjëra në fushën e dashurisë, për të vëndosur më shumë mirëkuptim me partnerin. Hëna mika u shtyn të ndërtoni, por mbajni sytë hapur kur vjen puna për bazën materiale.

GAFORJA

Gjithçka do të shkojë për më mirë, mbi të gjitha nëse kërkoni të veproni në aktivitetin tuaj, gjithmonë duke u bazuar në kriteret e paanshmërisë dhe respektit për të tjerët. Venusi do të jetë pak dinak ndaj jush, dhe sot do të keni si situata pozitive ashtu edhe kokëçarje të vogla.

LUANI

Po jetoni një histori të bukur dashurie ndaj bëni kujdes për të mos e ndërlikuar çka është e thjeshtë. Kush është beqar ka mundësi të shkëlqyera për një takim të këndshëm. Organizoni një shëtitje në natyrë për të medituar mbi zgjedhjet e juaja më të fundme.

VIRGJERESHA

Me pozitivitetin e tyre Dielli dhe Hëna ju mbështesin për të pasur një ditë të mbarë. Do të dini të përballemi me qetësi me çdo rrethanë. Dita e sotme do të karakterizohet nga entuziazmi si edhe me perspektivave të mira që parashikohen.

PESHORJA

Mësoni të vëzhgoni dhe do të zbuloni se jeta në çdo ditë mund t'ju dhurojë ato gjërat e vogla të bukura që mund të bëjnë të lumtur cilindo prej nesh. Bëni kujdes nga lodhja nervore pasi jeni shumë të ndjeshëm ndaj gjendjen emocionale të atyre që ju rrethojnë.

AKREPI

Ditën e sotme, me ogurin e mirë nga bashkëprejmi i Uranit, Saturnit, Jupitit dhe Plutonit, do të përjetoni gjëra të reja pozitive në fushën e dashurisë. Keni nevojë të ndryshoni, të bëni gjëra të reja, të sillni ndryshime të frytshme në ekzistencën e juaj.

SHIGJETARI

Për shkak të planetëve që janë shumë tekanjorë ndaj jush, nganjëherë kush ju qëndron pranë mund t'ju duket se ju kundërshton. Kërkoni një bisedë sqaruese. Shkruar duke pasur qeni nën ndikimin e theksuar Uranit, mos e merrni çdo gjë për të mirëqenë.

BRICJAPI

Me mbështetjen që keni nga Urani nuk duhet të ngadalësoni ritmin për të realizuar një projekt me sukses. Ndoshta do t'ju duhet një kohë e gjatë, por kjo nuk përbën problem. Në jetën në çift, Jupitieri do t'ju ndihmojë të stabilizoheni dhe të ndërmerri rrugën e qëndrueshmërisë.

UJORI

Me Plutonin që ju mbështet, thellohuni në gjërat që ju përkasin dhe ju interesojnë më shumë, dhe do të rrisni kompetencat tuaja profesionale. Plutoni bashkëpunëtor do t'ju ndihmojë të zgjeroni horizontin dhe të pasuroni lidhjet me të tjerët.

PESHQIT

Bashkëprejmi i Marsit me Venusin ju dhuron energji për t'ju përkushtuar angazhimeve të përditshme. Ndërsa Saturni ju mbështet me ide gjelbra për të lëvizur gjithçka. Do t'ia dini të nisni një projekt që po e mendoni prej shumë kohësh: rezultatet nuk do të vonojnë.

Opinion i Ditës

Histori e shkurtër e Rosisë dhe Putin

Nga Dritan Hila

(vijon nga faqja 1)

... e tokave shqiptare". Kjo të paktën deri në shpalljen e Pavarësisë.

Gjithë luftërat mes Perandorisë Otomane dhe Perandorisë Ruse para vitit 1912 në mbyllje do të kishin Traktatin e Paqes, i cili përfshinte edhe një shtrirje të sllavëve të jugut mbi trojet e të mundurve, të cilët fati e kishte sjellë që të ishin shqiptarët. Traktati i Shën Stefanit, Konferenca e Berlinit të shekullit të 19-të shënjuan rëndë tokat shqiptare në favor të miqve të Rosisë.

Pas Pavarësisë shqiptare, do të vinte Lufta e Parë Botërore dhe Revolucioni i Tetorit që solli karantinën e Rosisë nga fuqitë e tjera të mëdha. Si rrjedhim ra pesha e saj në konfigurimin e kufijve europianë. Por kjo nuk e bëri inaktive. Pavarësisht se e izoluar nga pikëpamja diplomatike tashmë Rusia kishte një ambasador më të fortë. Dhe ky ishte komunizmi.

Ideologjia e shpallur nga Marksi dhe që kishte gjetur fole në Moskë, ishte një nga armët më të forta të Moskës për të penetruar në vendet e tjera. Partitë komuniste të perëndimit konsideroheshin nga qeveritë perëndimore si agjenci spiunazhi të Moskës. Dhe jo rrallë spiunazhi rus rekrutonte agjentët e tij nga radhët e ish-komunistëve. Riçard Zorge, një komunist gjerman është më i famshmi.

Por jo gjithmonë ishte i nevojshëm rekrutimi direkt. Komunistët e shikonin Moskën si atdheun e tyre të dytë.

Në këtë kohë, ndërhyrja e Moskës në punët shqiptare nuk ishte shumë e ndjeshme. Përveç gojëdhënave për një përkrahje të Fan Nolit dhe revolucionit të tij nga zyra e spiunazhit sovjetik në Vjenë, e cila është më shumë legjendë, nuk ka dokumente apo dëshmi të besueshme të ndërhyrjes ruse.

Kordoni sanitar, i përbërë nga shtete limitrofe me Rusinë, që fillonte nga Polonia dhe mbaronte në Turqi, e ruajti Shqipërinë nga ndërhyrja direkte. Ndihmoi në këtë edhe një lloj alergjie që kishte popullsia e veriut, e cila e shikonte Rusinë si mike të serbëve.

Ata pak komunistë që kishte vendi, më shumë ishin idealistë romantikë sesa të rrezikshëm dhe me lidhje me Moskën.

Nga fundi i mbretërimit të tij, me një gjyq spektakolar, qeveria e Ahmet Zogut dënoi një pjesë të madhe të komunistëve shqiptarë ku spikaste Qemal Stafa. Ky gjest tlati të tjerët.

Duhet të vinte sulmi gjerman mbi Bashkimin Sovjetik që rusët të bëheshin aktivë. Komunistët ishin një material i mirë për vepërimitarë subversivë në prapavijat gjermane. Por në Shqipëri rusët nuk ndërhyrë direkt, por ia lanë përgjegjësinë e organizimit të ko-



munistëve shqiptarë, jugosllavëve. Për ata jugosllavët ishin më të kualifikuar dhe të kontrolluar. Një pjesë e udhëheqjes jugosllave, përfshirë Titon kishin ndenjur në Hotel Lux në Moskë, i famshëm si vendstrehim për të gjithë komunistët e arratisur nga vendet e tyre dhe që më vonë do të ridërgoheshin në vendet e origjinës pas përgatitjes ku nuk mungonin as kurset e luftës së fshehtë.

Do ishin dy komunistë jugosllavë që shërbyen si ngjizës të komunistëve të pakët dhe përçarë shqiptarë: Dushan Mugosha dhe Vukmanović Tempo. Këta ishin të parët dhe pas tyre do të vinin të tjerët.

Pavarësisht se në vitin 1944 Ushtria e Kuqe nis një major të vetin në mision ndërlihdës pranë shtabit të përgjithshëm shqiptar, kanali i komunikimit të komunistëve shqiptarë me Moskën do të mbetej gjithmonë Beogradi.

Në vitin 1948 në Konferencën e Paqes së Parisit, në kundërshtim me afrinë historike që ortodoksët e Rosisë kishin pasur me Greqinë, e cila i kishte penalizuar shqiptarët në të shkuarën, Bashkimi Sovjetik si një ndër katër fuqitë fituese, garanton mosndarjen e Shqipërisë. Ishte koha kur ideologjia prevalonte mbi kombin dhe fenë. Por edhe në këtë rast ish-

te ndërmjetësimi i Jugosllavisë, e cila luante rolin e tutorit, deri në vitin 1948 kur Tito shkëputet nga Moskë dhe Enver Hoxha shfrytëzon rastin të vendosë kontakte direkte me Kremlinin.

Ky ishte viti kur edhe mijëra shqiptarë filluan të shkonin të shkolloheshin në Rusi dhe mijëra këshilltarë rusë erdhën në Shqipëri.

Ishte periudha kur dy vendet patën marrëdhëniet më të ngushta në historinë e tyre, e cila përveç marrëdhënieve politike, ushtarake dhe diplomatike njohu edhe një fuqizim të ndihmës ekonomike dhe ushtarake.

Pas vitit 1961 marrëdhëniet mbeten të ngjira për t'u shkëputur krejtësisht në vitin 1968 kur Shqipëria doli nga Traktati i Varshavës. Shkëputje, e cila e bëri Enver Hoxhën të rrisë vigjilencën e tij ndaj njerëzve që ishin shkolluar në Moskë apo me lidhje familjare. Eksperiencia e vendeve të lindjes i kishte treguar se ky ishte kontingjenti nga mund t'i vinte përmbysja.

Rënia e komunizmit në të dy vendet nuk solli ndonjë ndryshim të madh. Shtytësi ideologjik nuk vepronte më. Kishin mbetur vetëm interesat shtetërore.

Rusia nuk ishte më ajo e para. Dhjetëvjeçari 1990-2000 ishte peri-

udha e lëpirjes së plagëve. Varfëria nga kishte dalë, shto edhe konfliktet ndëretnike nuk e lejonte të projektonte fuqinë e saj jashtë kufijve.

Derisa erdhi viti 2000 kur Jelcin do ia linte fuqinë një ish-officer të shërbimeve sekrete të quajtur Vladimir Putin. Putin ishte një rekomandim i oligarkëve hebrej që rrinin rreth Tatjanës, vajzës së Jelcin. Berezovski mendonte se do ta komandonte. Por ishte gabuar.

Ish-officeri i shërbimit të jashtëm të KGB me dorë të hekurit shtyp kryengritjen çeçene. Ju hoqi autonominë rajoneve. Nuk bën pakte me terroristët pavarësisht jetëve njerëzore të humbur në teatrin Dubrovka të Moskës dhe shkollën e Beslan. Një Car i ri kishte ardhur në Kremlin.

Putin është një kombinim i Ivanit të tmerrshëm sa i takon mospërfilljes për jetët njerëzore kur këto i duhen për qëllimin; i Pjetrit të madh kur i duhet të rindërtojë Rusinë dhe i Stalinit sa i takon qëndrimit ndaj të shkuarës dhe vizionit gjeopolitik. Si i tillë nuk mund të bëjë përjashtim në armët që përdor. Janë ato ku është mbështetur në mijëvjeçarë Rusia: ushtria dhe shërbimet sekrete. Në këtë kuadër lancon një plan dhjetëvjeçar prej 200 miliardë dollarësh për modernizimin e ushtrisë. Kjo përveç buxhetit vjetor

Ndërkohë ndërhyr në Gjeorgji dhe së fundmi në Ukrainë duke aneksuar Krimenë. Siria është hapi i fundit i tij. Rusia nuk po le cep te globit pa qene aktive.

Gjithë këtë kohë shërbimet perëndimore nuk rreshtin së përmenduri aktivizimin e agjenturës ruse. Nëse rastet e Aldrich Ames e me vonë Ana Chapman ngjanin si raste sporadike, gjithmonë e më shumë me kalimin e kohës shërbimet e specializuara perëndimore sinjalizonin rritjen e aktivitetit të agjenturës ruse. Por këtë radhë e kombinuar edhe me spiunazhin elektronik. Akuzat arrijnë deri në ndërhyrjen në zgjedhjet presidenciale në Shtete e Bashkuara.

Nëse rasti i Hillari dhe ndërhyrja e operativeve rusë është diçka mes ficton dhe realitet, në vendet e lindjes vihet re një rritje e ndikimit të Moskës. Disa e komentojnë me afrinë më sllavëve. Të tjerët me dëshirat autoritariste të udhëheqësve lindorë. Dhe të tjerët me afërsinë e trashëguar ideologjike që kanë pasardhësit e komunistëve për ish-atdheun e komunizmit. Të gjitha këto nuk është çudi të kalojnë edhe në filtrin e shërbimeve sekrete ku rusët kanë qenë gjithmonë profesionistë shumë të zotë.

Ndërkohë Britania e Madhe është një shesh beteje i FSB, trashëgimtarja e KGB. Që nga rasti i vrasjes me polonium të dezertorit Litvinenko; vetrasja e dyshimta e opozitarit të Putin, Berezovskit; rasti Skripal, dhe deri ditën e djeshme me rastin Glushkov, shërbimi sekret rus tregon se fjalët ndaj tij nuk janë vetëm legjenda urbane apo luftë mediatike.

Dhe ja ku vijmë në teatrin shqiptar.

A është Shqipëria një vend që ndjell orkesat e Moskës? Kjo vështirë të thuhet. Një raport komplotist për ndërhyrje në zhvillimet shqiptare nuk është shumë rentabel. Shqipëria ka peshë të vogël në teatrin Ballkanik krahasuar me Serbinë apo Bullgarinë që kanë popullsi dhe peshë politike më të madhe.


Ndërkohë në kohën e protestave të PD përpara zgjedhjeve u fol për praninë e agjenturës ruse në Tiranë. Ky fakt u hodh poshtë nga ambasada e tyre.

Por kush janë asetet që mund të bashkëpunojnë me Rusinë?

Aktualisht akuzat janë mbledhur mbi shefin e demokratëve Lulzim Basha dhe një financim që mund të ketë pasur ai nga një shoqëri e komanduar nga dy ish-officerë të FSB. Por nuk mungojnë as akuzat e krahut tjetër që e cilësojnë Partinë Socialiste si pasardhëse të komunistëve edhe më të predipozuar për flirte me Rusinë.

Cila është e vërteta. Kjo vështirë të thuhet. Sepse është një betejë, e cila e gjitha zhvillohet nën tokë dhe ajo që shikon publiku rrallëherë është e vërteta.

Fjalëkryqi (1)




HORIZONTAL

1. Bëjnë arte me re.
2. Krijoi Arsene Lupin (inic).
3. Janë forma.
10. Në hyrje të plazhit.
11. Kapen të parat.
13. Janë ufo.
14. Mbahen nga ata që i thyejnë.
18. Inicialet e Mascagni-t.
19. Në krye të trupave.
20. Eshhtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
22. Pak hemorrhagji.
23. U shkrua nga Jack London.
25. Institucione Ndërkombëtare Europiane.
26. Scarlet e Bashkë me erën.
27. Janë tituj në ekran.
29. Eric aktor.
31. Kështu e ka syrin vigjilent!
32. Janë nofka.
35. Një provë... inteligjence.
37. Mund të jenë me sahat.
38. Një pjesë e naivitetit.

40. Pak imagjinatë.
 42. Pikat pa kufij
 43. Fillojnë aksionin.
 44. Kërkohej nga poetët.
 47. Nota e diapazonit.
 48. I prin kolonës.
 51. Eshhtë filozofie moralit.
 52. Ulet në dhomën e lartë.
- VERTIKAL**
1. Malet pa kufij.
 2. Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
 4. Inicialet e Altman.
 5. Një sportist që arrin majat
 6. Courier ish-kampion i tenisit.
 7. Fillojnë testin.
 8. Mund të jetë parabolike.
 9. Bie me ballë.
 10. Camera, ish-kampion i ringut.
 11. Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit.
 12. I kanë rrënjët në tokë.
 15. Eshhtë pushkë.
 16. Brown i Kodit i Da Vinci-t.
 17. Takim Brezash Durrës.
 21. Ishite lumi i Elizit
 22. Eshhtë kardinal.
 24. Mbyllin një krah.
 28. Artikull anglez.
 30. Mbyllin fushatat.
 31. Partia pa ara.
 32. Zola që shkroi Nana
 33. Nganjëherë duhen vënë mbi i.
 34. Një fjalë kastle
 36. Inicialet e Mann shkrimtar.
 39. Maiden që këndojnë.
 41. Ai i shtatë është kinemaja.
 43. Fillojnë arsyetimin.
 45. Eshhtë nënë e Tironës.
 46. Eshhtë shahu i fundit.
 48. Inicialet e Klee piktor.
 49. Dy asa.
 50. Mbarojnë fare.

Fjalëkryqi (2)



HORIZONTAL

1. Patricia këngëtare.
5. I vocërr ai i Migjenit
9. Hari spiune.
12. Qyteti i Robespierre.
14. Phineas i famshëm i cirkut.
16. Pak latinisht.
17. Inicilet e Banderas.
19. Janë tek në rrota.
20. Pak efikasitet.
22. Eshhtë shkolla fillore.
24. Arrihet duke aderuar
27. Pak iniciativë.
28. Një... art i Don Judd.
29. U kompozua nga Rachmaninov.
31. Diku në qendër.
32. Një është për të lidhur.
33. Jepet për hartim.
35. Sergej, poet i famshëm rus.
37. Veriu pa kufij.

VERTIKAL

1. Eshhtë edhe ai i sheqerit.
2. Eshhtë lloj papagalli.
3. Një Pop i Andy Warhol.
4. Sapo fillojnë.
6. Qendër në Kubë.
7. Eshhtë pluhuri si Dash.
8. Eshhtë e hollë dhe therëse.
9. Fillojnë muzikën.
10. Një kontinent i ri.
11. Eshhtë për medaljen e parë.
13. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve.
15. Provinca e boerëve.
18. Eshhtë qyteti i njëmbinjë dritareve.
21. Eshhtë dukuria.
22. Eshhtë hidrokarbur.
23. Griffith aktore.
25. Qe perëndesha e fitores.
26. Mbeten në fund.
30. Tregon çmimin.
34. Këndohet në opera.
36. Para Fe në New Mexico.
37. Eshhtë princ arab.
38. Tony që këndon Quando, quando, quando.
40. Bën mëza.
45. Pak tolerante.
47. Modem pa zë.
48. Pak marramendëse.
50. Mbyllin një dyqan.
52. Fillojnë teorikisht.

Gjeni ndryshimin

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

5	8							9
			7	5				2
3	1	9						4
						9	4	
9	3					1		6
	6	8						
6				8	5	1		
	7		9	5				
9						7	6	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	2	8	6	9	1	7	3	4
6	9	4	7	2	3	8	5	1
1	7	3	4	8	5	2	9	6
7	5	9	1	6	8	3	4	2
8	6	1	3	4	2	9	7	5
3	4	2	5	7	9	6	1	8
4	8	6	9	5	7	1	2	3
9	3	5	2	1	6	4	8	7
2	1	7	8	3	4	5	6	9

Përgjigjet e fjalëkryqeve të numrit të kaluar

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Argëtim filozofik

- I thashë Zotit, "Më ruaj nga armiqët" dhe fillova të humbas miqtë...

- Mos akuzo njerëzit për zhgënjimet e tua, akuzo veteveten që ke pritur shumë nga njerëz që s'duhej të prisje asgjë.

- Vdekja e pyet Jetën: Pse ty të duan kaq shumë dhe me çmenduri, ndërsa mua më urrejnë? Jeta: Sepse unë jam një gënjeshtrë e bukur, ndërsa ti je një realitet i hidhur.

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3	19
6	4	1	3		11			3	1	19	15
13	4		3	2	4	3	2	4	5	3	
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3		18
13	5	11	6	4	5	10	3	5	3		14
19		3	2	16	1	4		2	3	2	
7	4	6	14	5	2			1	11	5	
8	11	1		6	11	14		4	2	18	11
5	2	10	3	2	11	6		18	4	4	2
18	8		4	5	7	6	14	6		3	5
15	2	3	2	11		2	11	6	5	10	5
5	3	2	14	2	3		7	2	3	5	3

B A S T E T P A P A
U R A T U R H P A
S A M M A R A I N I
T A M E R I K A N E T
P R O T E S T A N T E T
G J I G A N T I I R R
B E T O N E K B O A T
S A L I R A M A E
G O N T I T U L L A R
A R E S A O E N E
I A M E R E N G U E S

Thënie të mënçura

- Sida më e vështirë është të jesh vetvetja në një botë ku çdokush përpiqet të të bëjë të ndihesh ndrysh!
- Njerëzit e mirë e të drejtë u ngajnë pemëve të mëdha që lëshojnë hije për të tjerët, ndërsa vetë përveçohen nga rrezet e diellit.
- Bota është plot dyer, plot raste, fije të tendosura që presin t'u biash.
- Të jesh gjithmonë i ndershëm me veten, është një ushtrim i këndshëm.

(Ralf Valdo Emerson)
(Sigmund Frojd)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

